

GAZETA SHQIPTARE



Kryeredaktor: Erl MURATI
Zv/kryeredaktore - Rezarta DELISULA
Tel:(04)2359-104, Fax:(04) 2359-116 E-mail:gazetashqiptare@hotmail.com



Viti XXIV - Nr. 7603 E shtunë 28 Korrik 2018 Çmimi, 50 lekë (1.5 euro)

Opinion

Ditës

Idashur Pëllumb, sot, pas kaq ditësh m'ora e-mailin tënd. U gëzova që jeni të gjithë shëndoshë e mirë dhe sidomos u lumturova që më në fund ju erdhën ...

Vijon në faqen 22

Nga LEKA BUNGO

Cili do të jetë fati i Teatrit Kombëtar?



Opinion

Ditës

Gjykata Kushtetuese e Shqipërisë është efektivisht e mbyllur, për herë të parë që nga themelimi i saj në vitin 1992, pasi nga nëntë anëtarët e saj, tre janë ...

Vijon në faqen 21

Nga GJERGJ EREBARA

Si u rrëzua Gjykata Kushtetuese

Dokumentet 96

LISTA E DËSHMITARËVE

- 1)- Aristotel Papa në Rep. 309 Balshë.
- 2)- Edison Gjergo në Rep. 313, Tiranë.
- 3)- Luçiana Naraçi, lagj. 3, rr. "B. Curri", pr.
- 4)- Hiruska Zekthi, lagj. 2, rr. "Jeronim d."
- 5)- Kostandin Leka, lagj. 5, Blloku 50-vjetor.
- 6)- Dhimitraq Trebicka, lagj. 4, rr. "Mine P."
- 7)- Elsa Drita, lagj. 8, rr. "Blloku Miqësia".
- 8)- Ermir Grezda, lagj. 8, rr. "Konferenca e"
- 9)- Dhimo Gogollari, lagj. 2, rr. "Marsen K."
- 10)- Hektor Dule, lagj. 1, rr. "A. Visha", Blle
- 11)- Miltjadh Jorgji, lagj. 8, rr. "Lidhja e Pr"
- 12)- Nelson Çabej, lagj. 10, rr. "N. Avrami"
- 13)- Genc Haidari, lagj. 2, rr. "Jeronim d."



Dokumentet në librin e ri "Jeta paralele"

Nga Grezda, Dule dhe Gjergo, kolegët që spiunuan Maks Velon në diktaturë

Botimi i UET/ Vjehrra e akuzoi për dhunë, gruaja: U ndamë për qëndrime të huaja

Dosja sekrete e përndjekjes, hetimit dhe dënimit të Maks Velos ka ardhur në një libër me titullin "Maks Velo. Jetë paralele" përgatitur nga Alda Bardhyli dhe nën logon e "UET PRESS". Libri pati promovimin të premtën në orën 13:00 në UET. Në kuadër të debateve mbi të shkuarën, është hera e parë që publikohet dosja e përndjekjes ...

Në faqen 10-11

PRESIDENTI: DUHET TE RISHQYRTOHET, KA PROBLEME ME KUSHTETUTEN

META I KTHEN KUVENDIT LIGJIN PER TEATRIN E RI

Kreu i shtetit kundër shembjes së Teatrit, PD-LSI përshëndesin vendimin. Veliq: Jam i zhgënjyer, por në shtator nis puna. Basha: Aferë për kullat



(Në foto) Presidenti i Shqipërisë, Ilir Meta

Në faqen 2-3

HISTORIA PAS ATENTATIT

Eksplziv në Bathore, kamerat e sigurisë kapin autorin që vrapon

Në faqen 5

KOMISIONERI I BE

Han: Përgatitja e negociatave të përfundojë brenda 14 muajsh

Në faqen 4

PROKURORI I TIRANES

Vetingu, Dritan Rreshka kundër ILDKP: Raport i njëanshëm

Në faqen 6

VITI I RI SHKOLLOR

Lista e teksteve që fëmijët do mund t'i tërheqin pa pagesë

Në faqen 8

SPECIALE



15 vjet rrugëtim e sfidë akademike, universiteti 'Luara' zgjedhje e zgjuar

Në faqen 8




Historia e lidhjes së koreografit me prezantuesen. Ja deputetët që pushojnë në jugun e Shqipërisë

Albi Nako zyrtarizon lidhjen me balerinën

Xherdan Shaqiri, me të dashurën në SHBA. Pushimet luksoze të Elvana Gjatës

Nga NGA EGLA XHEMALI

Prej gati një viti balerina Alba Hoxha përfillet se është dashuria e re e koreografit të njohur, Albi Nakos. Të shumta kanë qenë rastet kur të dy janë munduar t'i shmangen përgjigjes, nëse janë apo jo



në të vërtetë në një romancë. Por duket se zërat edhe pas një viti nuk janë mundur të shuhën. Ditët e fundit ka qenë vetë balerina, ajo që ka "provokuar" fansat duke postuar një foto me unazë. "Unazën e gjeta, por më mungon..." ...

Suplement

LIGJI PËR TEATRIN PRESIDENTI

9 argumentet pse presidenti kërkoi rishqyrtimin e ligjit nga Kuvendi

Ligji për teatrin, Meta nuk e dekreton: Cenon Kushtetutën

"Çështja duhet të marrë kohën dhe vëmendjen e duhur nga deputetët"

Darina Tanushi

Presidenti i Republikës, Ilir Meta i riktheu Kuvendin për rishqyrtimin e ligjit për teatrin dhe godinës së Teatrit Kombëtar. Katër ditë para përfundimit të afatit të dekretimit, Presidenti Meta vlerësoi se në kushtet kur Gjykata Kushtetuese nuk është funksionale dhe përgjegjësia fundore i bie atij për të vlerësuar kushtetutshmërinë e ligjeve, ta rikthejë atë në Kuvend "me qëllim që kjo çështje, të marrë kohën dhe vëmendjen e duhur, për t'u vlerësuar përsëri nga Kuvendi". Ky ligj shkel parimet e barazisë përpara ligjit dhe 'lirisë së veprimtarisë ekonomike të shtetasve', parime këto të cilat gëzojnë një mbrojtje të veçantë nga Kushtetuta. Së dyti, ligji nr. 37/2018 nuk është në harmoni me parimet themelore kushtetuese të identitetit kombëtar dhe trashëgimisë kombëtare mbi të cilat qytetarët e Republikës së Shqipërisë kanë vendosur të ngrenë dhe zhvillojnë shtetin e tyre. Së treti, ligji nr. 37/2018 bie ndesh me parimet e Konventës Evropiane të Trashëgimisë Kulturore Jomateriale, miratuar në Paris në vitin 2003, duke bërë kështu që veprimtaria legjislativë të bjerë ndesh edhe me të drejtën ndërkombëtare të detryrueshme për zbatim, vlerëson në argumentimin e tij ligjor kreu i shtetit. Sipas tij, ky ligj "cenon rëndë parimet kushtetuese të ndërtimit dhe funksionimit të organeve të pushtetit vendor të 'decentralizimit' dhe 'autonomisë vendore', duke rëndësuar njëkohësisht edhe me parimin e ndarjes dhe balancimit të pushteteve". Po ashtu, vlerëson Meta, "ligji nr. 37/2018 vjen në kundërshtim me standardet dhe vlerat e Bashkimit Evropian dhe parashikimet e Marrëveshjes së Stabilizimit-Asociimit (MSA), plotësimi i të cilave është detyrim parësor për Republikën e Shqipërisë". Sipas kreu të shtetit, "propozimi i projektligjit, por edhe vetë ligji i miratuar nr. 37/2018 nuk mbështetet në një vlerësim gjithëpërfshirës dhe të plotë për jetërisimin e pronës publike, krahasuar me përfitimet ekonomike të shtetit shqiptar dhe interesin publik", si pikë të shtatë të argumenteve kundër ligjit, presidenti shprehet se, "ky ligj nuk është në harmoni me parimet dhe standardet e vendosura tashmë në legjislacionin në fuqi në Republikën e Shqipërisë". Së teti, miratimi i ligjit nr.37/2018 nuk është bazuar në një verifikim dhe vlerësim të thelluar të statusit të pasurive të paluajtshme që përfshihen në këtë projekt, si dhe dispozitatë e këtij ligji krijojnë pasiguri juridike në ushtrimin e të drejtave pronësore qoftë për pasurinë publike, por edhe mbi të drejtat private të pronësorë. Së fundmi, në kushtet aktuale, kur

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë nuk është funksionale për të verifikuar këto konstatime, apo për të zgjidhur çdo mosmarrëveshje kushtetuese që mund të prodhojë hyrja në fuqi e kësaj norme të veçantë ligjore, ftoj Kuvendin e Shqipërisë, të rishqyrtojë në tërësi ligjin nr.37/2018 "Për përcaktimin e procedurës së veçantë për negociimin dhe lidhjen e kontratës me objekt: Projektimi dhe realizimi i projektit urban dhe godinës së re të Teatrit Kombëtar". Duke u kthyer në historikun e shpejtë të zhvillimit të kësaj çështjeje. Institucioni i Presidentit të Republikës vlerësoi përpunueshmërinë e këtij ligji me Kushtetutën, duke bërë një analizë të kujdesshme të përmbajtjes së tij, për sa u takon efektet pozitive të aplikimit të kësaj norme të re ligjore, që sipas argumentit kryesor të qeverisë dhe Kuvendit, është ndërtimi i Teatrit të ri Kombëtar me kosto zero, në raport me respektimin e parimeve kushtetuese, interesit publik, si dhe ruajtjes së vlerave historike të trashëgimisë kulturore dhe identitetit kombëtar. Në shqyrtim të kësaj çështjeje, Presidenti i Republikës ka ndjekur me vëmendje dhe ka vlerësuar të gjitha qëndrimet publike, të shprehura pro, apo kundër miratimit të këtij ligji. Presidenti i Republikës ka ndjekur me vëmendje të gjithë qëndrimet publike: të Bashkisë së Tiranës, qeverisë dhe përfaqësuesve të Kuvendit në lidhje me këtë çështje.

Në përfundim të shqyrtimit të ligjit nr.37/2018 "Për përcaktimin e procedurës së veçantë për negociimin dhe lidhjen e kontratës me objekt "Projektimi dhe realizimi i projektit urban dhe godinës së re të Teatrit Kombëtar", Presidenti i Republikës çmon se ky ligj, i paraqitur për shpallje, nuk është në përputhje me parimet kushtetuese, aktet ndërkombëtare e Republikës së Shqipërisë aderon apo që ka ratifikuar. Gjithashtu, fryma e këtij ligji shkon në kundërshtim me sistemin ligjor aktual, mbi të cilin zhvillohet shoqëria shqiptare. "Nëse ky sistem ligjor i përgjithshëm cenohet dhe veprimtaria e ligjëvënësit orientohet shpesh e më shpesh për të miratuar ligje që rregullojnë një marrëdhënie të caktuar me një individ apo subjekt të caktuar ekonomik, atëherë roli rregullator i shtetit individualizohet nëpërmjet trajtimit preferencial dhe si rrjedhim, në mënyrë të pashmangshme, duke sjellë kështu parazi dhe cenim të veprimtarisë së lirë ekonomike. Pra, në këtë formë funksionimi, shteti nëpërmjet ligjeve të posaçme që nxjerr, del nga zbatimi i parimit të përgjithshëm të shtetit të së drejtës dhe individualizim trajtimit dhe shoqërisë nëpërmjet normave ligjore të ndryshme", shprehet presidenti në argumentimin e tij. "Pikërisht ligji i miratuar nr. 37/2018, referuar mënyrës sesi ka përcaktuar të trajtojë kompanitë private propozuese, duket se shkel njëkohësisht parimin e barazisë përpara ligjit dhe lirisë së veprimtarisë ekonomike të shtetasve. Në rastin konkret, rezultoni se kërkesa për shprehje interesi i paraqitur nga kompania propozuese është vlerësuar apriori si propozimi më i mirë, duke bërë kështu dhe pranimin automatik të faktit të kryer se ky është propozimi më i mirë, por në rastin konkret, pa asnjë procedurë konkurrimit të hapur dhe transparente.



Presidenti i Republikës, Ilir Meta

Konkretisht, paracaktimi i drejtpërdrejtë me ligj nga Kuvendi i një operatori ekonomik, me të cilin shteti ka zgjedhur të bashkëpunojë për të kryer një punë publike, duke shfrytëzuar dhe tjetërsuar pasurinë publike, pa i nënshtuar më parë një procesi transparent të hapur konkurrimit, shkel parimin e barazisë përpara ligjit dhe cenon në mënyrë të drejtpërdrejtë lirinë e veprimtarisë ekonomike - thuhet nga presidenti.

Procedurat e propozimit të këtij projektligji dhe miratimi i tij nga Kuvendi rezultoi

vite - shprehet kreu i shtetit. Meta vlerëson se konkluzionet që janë arritur mbi vlerat e kompleksit ekzistues të godinave të Teatrit Kombëtar të lidhura me nevojën për ndërtimin e një godine të re, janë bërë bazuar në një vlerësim jo të plotë e të thelluar, duke u fokusuar vetëm tek cilësia e ndërtimit të objektit aktual, ku ushrohet veprimtaria e Teatrit Kombëtar, sa i takon anës funksionale aktuale të tij apo arkitektures së përdorur.

Për këtë çështje, qeveria shqiptare dhe Bashkia e Tiranës duhet të tregojnë përkushtimin e tyre për krijimin e mjediseve në dobi të aktorëve dhe të publikut, duke synuar ndërtimin e godinave të reja funksionale bashkëkohore, por njëkohësisht pa dëmtoar trashëgiminë e krijuar ndër vite në kompleksin e godinave ekzistuese të Teatrit Kombëtar, pasi një humbje e tillë do të ishte përfundimisht e parikuperueshme në të ardhmen. Presidenti i Republikës vlerëson se në lidhje me këto çështje kaq të ndjeshme, të gjitha argumentet duhet të balancohen vetëm me studime shtetërore shkencore, teknike dhe ligjore në ruajtje të trashëgimisë dhe vlerave historike kombëtare.

SIPËRFAQJA
Sipas relacionit sho-

PRESIDENTI

"Ky ligj shkel parimet e 'barazisë përpara ligjit' dhe 'lirisë së veprimtarisë ekonomike të shtetasve', parime këto të cilat gëzojnë një mbrojtje të veçantë nga Kushtetuta".

ton të jetë realizuar me procedura të përshtetshme. Nga relacioni shoqëruar në Kuvend, evidentohet se në zonën ku propozohet të zhvillohet projekti, truallin në pronësi të shtetit ka një sipërfaqe prej 8465 m², nga të cilat rreth 2100 m² janë në pronësi të Bashkisë së Tiranës. Në rastin konkret, propozimi konsiston në shfrytëzimin e të gjithë pronës publike, përfshi këtu ndërtesat dhe truallin prej 2100m², në pronësi të Bashkisë së Tiranës. Nisur nga fakti që propozimi i mbërtur kishte për objekt jetë-

simin e pronës publike "truall dhe ndërtesa", të cilat pjesërisht janë në pronësi të Bashkisë së Tiranës ishte e detyrueshme që kryetari i Bashkisë së Tiranës këtë shprehje interesi të subjektit privat duhet ta parashtronte paraprakisht për diskutim përpara Këshillit Bashkiak të Tiranës, i cili kishte dhe ka kompetencën për të shprehur vullnetin për tjetërsimin e sipërfaqes prej 2100 m² në pronësi të Bashkisë së Tiranës.



Gjatë një seance parlamentare

vlerëson se truallin publik për nga vendndodhja e tij në qendër të qytetit të Tiranës nuk duhet të tjetërsohet, pasi për sipërfaqen që ai paraqet mund të studiohet dhe shfrytëzohet mundësi për ndërtimin edhe të një Teatri të ri Kombëtar me fonde publike, duke krijuar kështu një mjedis të përshtatshëm për shfrytëzim për të ardhmen, por duke ruajtur njëkohësisht dhe historinë, kujtesën dhe trashëgiminë kulturore të krijuar në kompleksin aktual të godinave të Teatrit Kombëtar, të cilat duhet të mirëmbahen dhe restaurohen. Vetëm në këtë mënyrë kjo trashëgimi do të ruhej dhe do t'u transmetohej brezave të ardhshëm.

Në kushtet aktuale, kur Gjykata Kushtetuese nuk ushtron funksionet sublimë të saj, të kontrollit kushtetues të normave që nxirren nga qeveria dhe Kuvendi apo të interpretimit të Kushtetutës, roli i Presidentit të Republikës për të vlerësuar nismat ligjëvënëse merr një përgjegjësi tjetër, pasi mbetet institucioni i fundit ku veprimtaria legjislativë mund të kontrollohet mbi pajtueshmërinë e ligjit me Kushtetutën, ndaj edhe sipas argumenteve, ai ka vendosur që ky ligj duhet të rikthehet edhe një herë në Kuvend, me qëllim që kjo çështje të marrë kohën dhe vëmendjen e duhur për t'u vlerësuar përsëri nga Kuvendi.



Paralajmërimi i kreut të PD-së për presidentin: Do jemi në gjendje "luftë civile"

"Teatri", Basha: Grusht shteti nëse dekretohen

"Ligji i Magjistraturës, të zbatohen 7 pikat e opozitës"

Kryetari i Partisë Demokratike, Lulzim Basha deklaroi dje pak para se sa Presidenti i Republikës, Ilir Meta të mosdekretonte ligjin për teatrin, se një vendim "pro" ligjit të miratuar nga mazhoranca do të ishte "një grusht shteti". Në një bashkëbisedim me gazetarët, Basha u shpreh se interesi i qeverisë janë kullat. Ai tha se me shembjen e teatrit, vëhet prona publike dhe shkatërrohet trashëgimia kulturore. Basha tha se artistët janë manipuluar duke u bindur për firmosjen e peticionit. "Është një aferë prej 200 mln eurosh para publike. S'qihet më Tirana, por Tirana, kjo është ëndrra e psikopatit taleban. Kemi të bëjmë me një mashtrues serial. Shpresa dhe besimi im është që kuraja gazetareske do dalë mbi Edi Ramën. Kjo është çështja me të cilën do nisja bashkëbisedimin. S'ka projekt për teatër, ka projekt për kulla. Të gjithë ata që s'e kuptojnë, janë mashtruar. Artistët janë manipuluar në kërkesën e tyre për një teatër dinjitoz", tha Basha. "Do ndjekim gjithë hapat ligjorë. Shkelja e të gjithë mekanizmeve ligjorë, dekretimi në heshtje është pjesëmarrje në grusht shteti. E kam fjalën për çdo instancë që bëhet pjesë e kthimit të parlamentit në një Rajshtag të shtetit hitlerian e merr pushtete që nuk ia jep Kushtetuta. Nëse kjo vijë e kuqe shkellet, ne jemi de facto në gjendje lufte civile. Nëse i vëmë minat bashkëjetesës, s'do bëhemi kronikanë. Nëse ata i vëmë minat teatrit, ne do t'ua vëmë kullave, me ligj", u shpreh Lulzim Basha. Ai tha se Partia Demokratike është duke përgatitur një padi për arkitektin belg, Bjarke Ingels për projektin e Teatrit Kombëtar. "Për Bjarke Ingels po përgatitet një padi penale. Po përgatitet gjithçka edhe në prokurorinë belge. Dhe mbi çdo blerësi që po merr pjesë në këtë krim monstruz", theksoi Basha. I pyetur nga gazetarët për ligjin e magjistraturës, kreu i PD-së u shpreh se opozita nuk ka për ta votuar një ligj të tillë, ku bordi është i përbërë nga anëtarë të PS-së. "Bordi i shkollës së Magjistraturës është si bordi i shkollës 'Qemal Stafa'. Aty është gjithë nomenklatura e PS-së dhe e Partisë së Punës, cila është ajo opozitë që thotë po?", u shpreh Basha. Ai u shpreh i vendosur lidhur me qën-



Kreu i PD-së, Lulzim Basha

TAKIMI

"Në mënyrë absolute nuk jam takuar dhe nuk kam ndërmend të takohem me Edi Ramën. Por, do të bëj gjithçka, së bashku me PD dhe me aleatët tanë që t'i japim vendit një orë e më parë një qeveri me një kryeministër të palidhur me krimin, si hap i parë dhe i domosdoshëm për zbatimin e reformës në drejtësi, sipas Kushtetutës së 22 korrikut", tha dje Lulzim Basha.



Taulant Balla: Presidenti zgjodhi të mbajë farsën e opozitës me teatrin

Kryetari i grupit parlamentar të PS-së, Taulant Balla akuzoi Presidentin e Republikës se zgjodhi të mbajë gjallë farsën e opozitës, duke mos dekretuar ligjin për godinën e Teatrit Kombëtar. Në një reagim të tij, Balla u shpreh: "Në 21 janar 2011, Lulzim Basha ministër i Brendshëm dhe Sali Berisha kryeministër akuzonin protestuesit dhe opozitën për grusht shteti. Sot, 7 vjet më pas, Lulzim Basha dhe Monika Kryemadhi, që të dy në opozitë, akuzojnë shumicën qeverisëse për grusht shteti. Me një gjuhë që nuk ka asnjë lidhje me aspiratat europiane të Shqipërisë së vitit 2018, kreu i opozitës kërcënoi me ruspa e dinamit sipërmarrësit shqiptarë dhe arkitektët e huaj". "Fatkeqësisht sot thirrjeve të Lulit e Monës iu përgjigj Presidenti i Republikës, i cili deri më sot ka pasur një sjellje të admirueshme, duke mos u bërë palë as e politikave të familjes së tij, as e lojërave të partisë së tij. Presidenti zgjodhi të mbajë gjallë farsën e opozitës me teatrin, të po të njëjtëve individë që protestonin kundër parkut të lodrave, kundër bulevardit të ri, kundër Rilindjes Urbane në çdo qytet të Shqipërisë", theksoi Balla. "Ai që javë më parë i bënte thirrje autoriteteve shtetërore të gjenin gjuhën me artistët sa i takonte projektit të teatrit, sot vendosi kundër vullnetit të artistëve, duke mbështetur lojën e opozitës. Shumica parlamentare, në mbështetje të dekretit të Presidentit dhe Kushtetutës, do të rivotojë projektligjin në fjalë menjëherë sapo parlamenti të rimblidhet në shtator për t'u dhënë shqiptarëve dhe artistëve një teatër të ri, modern dhe dinjitoz".

Kreu i Bashkisë së Tiranës shpreh zhgënjim për vendimin e presidentit

Veliaj: Do presim edhe 40 ditë që parlamenti ta rivotojë në shtator

Kryetari i Bashkisë së Tiranës, Erion Veliaj shprehu dje zhgënjimin e tij për vendimin e Presidentit të Republikës për kthimin e ligjit për teatrin. "Kthimi nga presidenti i ligjit që do t'i jepte Tiranës sonë një teatër të ri, modern, i projektuar nga një prej arkitektëve më në zë të gjeneratës sonë, ishte një zhgënjim! Jo sepse presidentët, në të kaluarën, nuk janë bërë palë me partitë politike për të kundërshtuar projekte si ai i Këndit të Lodrave të Liqenit, por sepse mendova se pas 3 vitesh progres në qytetin tonë, me një shesh të ri, një bulevard të ri, një Pazar të Ri e një Unazë të Re, e kishim tejkaluar kohën e sabotimeve të qytetit dhe se ishte krijuar pjekuria për të dalë mbi par-



ditë e mbi familjet politike në vend", deklaroi Veliaj. Ai shton më tej se, "teatri i sotëm në kryeqytet, me kryetarë bashkish nga Kamza e Shkodra, që kanë probleme serioze me funksionimin qytetevë të tyre, mund të na ishte kursyer. U ngjan protestuesve të importuar nga ish-presidenti për Këndin e Lodrave. Të gjithë e dimë si përfundoi ajo betejë: Presidenti u diskreditua në histori si një noter partiak. Kurse, ultimatumit prej

kalamani të SHQP-it nga ish-gjumashi i Bashkisë së Tiranës nuk do kalonte dot as një audicion për teatër kukullash". Ai e konsideron si një skenar të qepur keq në paraprëjtë të refuzimit të ligjit, që fyen inteligjencën e kujtdo që i thotë vetes qytetar. Ky vendim sipas, Veliajt solli një dobi, sepse ndau qartazi palët në Tiranë. "Teksa priten 40 vjet për një teatër të ri, do presim edhe 40 ditë që parlamenti ta rivotojë në shtator e t'i hapë rrugë projektit modern - në tokën e vet e me teknologjinë më të fundit", tha më tej, Veliaj. "Sidoqoftë, ne nuk do t'i humbasim këto detyrë ditë, por do bashkëpunojmë me komunitetin teatror që të jemi gati sapo të kalojë ligji", përfundon Veliaj.

sharak, sipas të cilit, mënyrën për të shkelur Kushtetutën, të mos e shkruajnë ata, por ne. Propozimi ynë është kthimi të institucionet e drejtësisë", u shpreh Basha. "Ata kanë 7 pika që trajtojnë këto kriza. Nëse PS ka me të vërtetë vullnetin që t'i japë fund kapjes në drejtësi, i ka propozimet tona. Ne jemi pro që t'u jepet jetë 7 propozimeve tona. Ne kërkim që të mos kemi prokurori të përkohshëm. Tani s'ka mirëkuptim. Ata s'kanë ndërmend që të zbatojnë reformën në drejtësi", tha Basha.

Procesi i bisedimeve të Shqipërisë me Greqinë udhëhiqet nga parimet e së drejtës ndërkombëtare, nga Konventa mbi të Drejtën e Detit, nga parimet e së drejtës kushtetuese dhe legjislacionet respektive. Këtë përgjigje ka dhënë ministri për Europën dhe Punët e Jashtme, Ditmir Bushati gjatë një intervistë për "Zërin e Amerikës", në lidhje me deklaratën e homologut të tij grek, se "shumë shpejt Greqia do të zgjerojë ujërat territoriale".

"Unë nuk e di se çfarë ka dashur të thotë ministri i Jashtëm grek, por di që i gjithë procesi i bisedimeve me Greqinë udhëhiqet nga parimet e të drejtës ndërkombëtare nga konventa mbi të drejtën e detit, nga parimet e së drejtës kushtetuese dhe legjislacionet respektive", u përgjigj kreu i diplomacisë shqiptare. Ministri Bushati ka theksuar se negociatat

Ministri i Jashtëm u përgjigjet deklaratave të homologut grek

"Zgjerohet ujërat territoriale", Bushati: Nuk e di çfarë ka dashur të thotë Kotzias

DEKLARATA

"Unë nuk e di se çfarë ka dashur të thotë ministri i Jashtëm grek, por di që i gjithë procesi i bisedimeve me Greqinë udhëhiqet nga parimet e të drejtës ndërkombëtare nga konventa mbi të drejtën e detit, nga parimet e së drejtës kushtetuese dhe legjislacionet respektive", u përgjigj kreu i diplomacisë shqiptare. Ministri Bushati ka theksuar se negociatat

me Greqinë vijojnë dhe tashmë të dyja vendet janë në një fazë dialogu intensiv për të gjitha çështjet, qoftë ato me karakter dhe me peshë historike apo çështjet e aktualitetit politik. Ai tha se janë hedhur disa hapa të rëndësishëm përpara edhe për ato çështje, të cilat deri para pak vitesh konsideroheshin tabu, si kufizimi i zonave detare, ekzistenca e ligjit të luftës nga ana e Greqisë



Ministri për Europën dhe Punët e Jashtme, Ditmir Bushati

përkundrejt Shqipërisë, etj. Këto deklaratat ministri Bushati i bëri nga Uashingtoni, ku mori pjesë për 3 ditë me radhë, prej datës 24 deri në 26 korrik, në Ministerialin mbi Lirinë Fetare, i pari i këtij lloji, i cili organizohet nga sekretari amerikan i Shtetit Mike Pompeo.

Komisioneri i Zgjerimit, optimist për hapjen e negociatave në 2019-ën

Hahn: Përgatitja për negociatat të përfundojë brenda 14 muajve

"Qëllimi, të marrim dritë të gjelbër nga të gjitha vendet në mesin e vitit"

Për komisionerin e Zgjerimit, Johannes Hahn nuk ka dyshime se negociatat për Shqipërinë dhe Maqedoninë duhet të hapen në mesin e vitit të ardhshëm. Në një intervistë për agjencinë e lajmeve të BE-së, "Politiko" ai u shpreh se Tirana dhe Shkupi kanë nisur tashmë procesin e përgatitjes për qershorin e 2019-ës. Hahn tha se është "shumë i bindur" se negociatat për Shqipërinë dhe Maqedoninë mund të fillojnë vitin e ardhshëm, duke vënë në dukje se procesi i verifikimit të gatishmërisë së vendeve për negociata ka filluar tashmë. "Kjo është një punë gjithëpërfshirëse dhe shpresoj se mund ta përfundojmë në një vit deri në 14 muaj. Qëllimi është të marrësh dritë të gjelbër nga të gjitha vendet në mesin e vitit". Sipas Johannes Hahn, anëtarësimi i vendeve të rajonit është një mision historik. "Gjithçka filloi në '89 me rënien e Perdes së Hekurt", tha ai. "Zgjerimi i madh në 2004 ishte... një pasojë e parë e madhe. Dhe unë do të thosha se e gjithë kjo është përfunduar vetëm kur të gjashta vendet të jenë anëtarë të Bashkimit", u shpreh ai. Komisioneri i Zgjerimit u ndal edhe te Kosova, duke theksuar domosdoshmërinë e vijimit të dialogut mes Prishtinës dhe Beogradit, me qëllim që vendi të avancojë në rrugëtimin e integritimit evropian. Një nga barrierat e mëdha të Kosovës ndaj anëtarësimit në BE është se ajo duhet të zgjidhë mosmarrëveshjet e saj me Serbinë, vendin nga i cili shpalli pavarësinë në 2008-ën. Hahn vuri në dukje se qeveria e Kosovës mbështetet gjithashtu në tarifat doganore për të ardhurat dhe kjo do të duhej të ndryshonte para se të mundte bashkohet me tregun e vetëm të BE-së. Në këtë intervistë, Hahn u kthye kundër pikëpamjes së Macron. Ai tha se qytetarët e vendeve të Ballkanit Perëndimor,



Komisioneri i Zgjerimit, Johannes Hahn

PROCESI

Pak ditë më parë, komisioneri i Zgjerimit së bashku me stafin e tij ishte në Tiranë për të marrë pjesë në nisjen e punës për procesin e screening. Hahn tha se ky është hapi i parë në nisjen e procesit dhe i kërkoj qeverisë se për procesin e punës përgatitore të negociatave duhen njerëz të kualifikuar dhe burime të mjaftueshme buxhetore për misionin e dërguar në Bruksel.

zhvillojnë bisedimet e anëtarësimit. "Këndvështrimi im është ndoshta pak më ndryshe nga Presidenti Macron, ndoshta ne mund ta bindim atë që të dyja duhet të bëhen paralelisht", u shpreh Hahn. Planet aktualë të BE-së lënë dy vende të Ballkanit Perëndimor, Kosovën dhe Bosnjën dhe Hercegovinën pa as një afat kohor paraprak për bisedimet e anëtarësimit.

Ambasadorja franceze nga Korça: Shqipëria të angazhohet në përbushjen e reformave

Ambasadorja franceze, Christine Vasak, ka folur nga Korça për reformën në drejtësi, duke deklaruar se Gjykata Kushtetuese duhet të vihet në funksion sa më shpejt të jetë e mundur. "Ka shumë etapa, të cilat duhen plotësuara, përshirë edhe nivelet më të larta të sistemit gjyqësor. Gjykata Kushtetuese duhet të vihet në funksion sa më shpejt të jetë e mundur. E gjithë klasa politike e di këtë", u shpreh Vasak. Ajo shtoi më tej se pas rekomandimit të Këshillit të Europës, perspektiva e negociatave duhet të bëhet realitet deri qershorin e vitit të ardhshëm dhe për këtë do të ndihmojë Magjistratura. "Ne besojmë në një Magjistraturë të formuar mirë, kurajoze, që vepron sipas ligjit. Kjo supozon të luftohet korrupsioni dhe krimi i organizuar. Rruga është e qartë dhe duhet punuar për realizimin e reformave", tha ambasadorja franceze. Sa i përket skepticizmit të disa vendeve europiane, Vasak u shpreh se rekomandimi për Shqipërinë ishte edhe kontribut i Francës, Holandës dhe vendeve të tjera. "Të mos flasim për skepticizëm, por Shqipëria duhet të angazhohet për përbushjen e reformave", u shpreh Vasak.

Ambasadori austriak flet për seancën e fundit të Kuvendit

Reforma në drejtësi, Sattler: Aty ku punohet, bëhen edhe gabime

Opozita nuk duhet të jetë patjetër dakord apo në një linjë me ndërkombëtarët kur bëhet fjalë për reformën në drejtësi. Ambasadori i Austrisë në Shqipëri, Johann Sattler, duke folur nga Korça tha dhe se vetë ka disa vonesa të vogla, por është në rrugë të mbarë. "Opozita nuk duhet të jetë patjetër dakord dhe në një linjë me ne. Roli i opozitës është në fakt që të jetë një opozitë e besueshme, të ofrojë alternativa dhe të sjellë opsione të tjera. Unë mendoj se ka, thjesht vonesa të vogla që do kalojnë", u shpreh ambasadori austriak. Megjithatë, diplomati austriak pranon që procesi ka edhe gabime. "Aty ku punohet bëhen edhe gabime. E rëndësishme është që drejtimi të jetë ai i duhuri dhe që shumë shpejt të kemi një sistem drejtësie shumë më të mirë se ai i 25 viteve të fundit", u shpreh Sattler. Ambasadori austriak shpreh keqardhjen që palët politike nuk arrijnë dot kompromis për të kaluar në Kuvend ligjin për shkollën e Magjistraturës, por nuk i humb shpresat. "Më vjen keq që në seancën e fundit parlamentare nuk u arrit në një kompromis. Por jam i bindur që do të ketë një mënyrë për të arritur një kompromis dhe për të gjetur një gjuhë të përbashkët", tha ai. "Besoj se kur flitet për reformën në drejtësi duhet të hedhim një shikim që kur filluam para 4 vitesh. Ndërkohë është shndërruar 1/3 e Kushtetutës, u hartuan 40 ligje të reja. Ndërkohë që ndodhemi në procesin e vetëgjetjes, me pak vonesa të vogla, por unë jam i mendimit që shumë shpejt do arrijmë në rrugën e duhur", u shpreh ambasadori i Austrisë.

NJOFTIM SHITJE ME ANKAND

ZYRA PERMBARIMORE GJYQESORE PRIVATE 'ILIA ELEZI'

Pasuria nr. 3/438+2-53, LLOJI 'APARTAMENT', VOLUMI 36, FAQE 37, SIPERFAQE 103 M2, ZONAKADASTRALE 8380, TIRANË, NË PRONESI TË Z. ALBAN QEMAL BALA.

CMIMI 12.016.000 LEKË . Data e zhvillimit të ankanit do jetë 08.08.2018 .

CEL. 0684026666 ; 0693262866 .

Shpërthim eksploziv në Bathore, shënjestër e sulmit i burgosuri për vrasje

I vendosën tritol në banesë, motra e Gazmir Dacit: Hera e pestë që na sulmojnë

"Ndihe mi të rrezikuar, në shtëpi ndodheshin fëmijët e mitur të moshës 3 dhe 4 vjeç"

Ina Allkanjari

Një sasi tritol ka shpërthyer në banesën e familjes Daci në Bathore të Tiranës mbrëmjen e së enjtes. Shënjestër e sulmit ka qenë familja e shtetasit Gazmir Daci, i cili aktualisht ndodhet në burg, pasi akuzohet për veprën penale të vrasjes së Valmir Kolaverit dhe plagosjen e vëllait të tij, Robertit. Nga shpërthimi në katin e parë të banesës ka pasur vetëm dëme materiale, ndërsa policia ka nisur hetimet për identifikimin dhe kapjen e autorëve. Familja Daci akuzon për këtë sulm familjen Kolaveri me të cilën prej vitesh ndodhen në konflikt. Në një intervistë ekskluzive për "Gazeta Shqiptare", motra e Gazmir Dacit tregon tmerzin e përjetuar në familje nga shpërthimi i eksplozivit, duke theksuar se në banesë ndodheshin edhe fëmijët të mitur të moshës 3-4 vjeç. Ajo akuzon familjen Kolaveri për sulmin, duke treguar se ky është rasti i katërt që kërcënohen nëpërmjet vendosjes së tritolit, ndërsa një rast tjetër kanë tentuar të ekzekutojnë në ambientet e burgut vëllain e saj. "Është hera e pestë që na sulmojnë. Dy herë na është vendosur tritol në shtëpi, dy herë te lokali, që është biznesi i familjes sonë dhe një herë kanë tentuar të vrasin vëllain në burg. Kemi kërkuar ndihmë nga shteti, nuk na japin asnjë lloj zgjidhjeje, kemi nevojë për mbrojtje", u shpreh motra e Gazmir Dacit në gjendje të rënduar psikologjike nga sulmi. Ndërkohë ditën e djeshme babai i Gazmir Dacit, Xhelal Daci paralajmëroi autorët se do të bëjë vetëgjyqësi, nëse shteti nuk merr masa.

Mbrëmjen e së enjtes banesa e familjes suaj është bërë shënjestër e një sulmi me eksploziv. Kush ndodhej në shtëpi në momentin e shpërthimit, pati të lënduar?

Në momentin e shpërthimit ndodhej në shtëpi motra, mami dhe tre fëmijët. U trembën shumë, dolëm direkt nga shtëpia dhe lajmëruam policinë, e cila erdhi në banesën tonë shumë shpejt. Nuk pati të lënduar, por fëmijët janë tmerruar, sepse janë të vegjël.

Patët mundësi t'i identifikoni autorët?
Jo, por shtëpia është me



Pamje nga banesa ku ndodhi shpërthimi



KONFLIKTI
Konflikti me familjen Kolaveri është i hershëm, thuajse prej 3 vitesh ndodhemi në këtë situatë. Jemi në gjendje shumë të rënduar psikologjike. Kërkojmë të drejtën tonë, policia të punojë dhe të gjejë fajtorët. Të kapen autorët, ne nuk e lëmë me kaq këtë gjë.

Një konflikt i nisur para vitit 2015 mes dy familjeve Kolaveri dhe Daci mësohet të ketë si motiv prishjen e pazareve për trafik klandestinësh. Konkretisht mësohet se konflikti mes djemve të dy familjeve kishte filluar në Francë. Në 4 nëntor 2015, pasi palët ishin kthyer në Shqipëri, në një lokal në Bathore Gazmir Daci vret Valmir Kolaverin dhe plagos vëllain e tij, Robertin. Një muaj më pas policia arriti të arrestojë Gazmirin, i cili u dënua me pas me 35 vite heqje lirie. Por këtu dyshohet se nisin edhe sulmet e familjes Kolaveri ndaj asaj të Dacit. Më datë 30.07.2016, rreth orës 16:30, në ambientet e ajrimit, brenda I.E.V.P. Vaqar, Tiranë, është plagosur me armë zjarri në pjesën e këmbës shtetasi Lili Dulaj, i dënua më parë në Kosovë për shkelje të rregullave të qarkullimit rrugor dhe i ndaluar me masë sigurimi "Arrest në burg", për veprën penale "Dhunë në familje". Nga hetimet ka rezultuar se ky person është goditur nga një distancë e konsiderueshme jashtë mureve rrethuese

Si i shpëtoi atentatit me snajper në 2016-ën Gazmir Daci

Konflikti mes dy familjeve, nga prishja e pazareve për trafik klandestinësh, në vrasje



Gazmir Daci

të këtij burgu dhe ndaj tij është qëlluar me një armë zjarri. Gjatë veprimeve të para hetimore ka rezultuar se shtetasi Lili Dulaj nuk ka qenë shënjestra e këtij atentati, por Gazmir Daci, i cili ndodhet në masën arrest në burg, për veprat penale "Vrasje me dashje", "Vrasje e ngjellur në tentativë" dhe

VRASJA
Në 4 nëntor 2015, pasi palët ishin kthyer në Shqipëri në një lokal në Bathore Gazmir Daci vret Valmir Kolaverin dhe plagos vëllain e tij Robertin. Një muaj më pas, policia arriti të arrestojë Gazmirin, i cili u dënua me pas me 35 vite heqje lirie. Por këtu dyshohet se nisin edhe sulmet e familjes Kolaveri ndaj asaj të Dacit.

"Armëmbajtje pa leje", pasi ky shtetas më datë 04.11.2015, pas një konflikti të mëparshëm, ka vrarë me armë zjarri shtetasin Valmir Kolaveri dhe plagosur rëndë vëllain e tij Robert Kolaveri, i cili aktualisht është i paralizuar. Mësohet se nga verifikimet e kryera nga grupi hetimor ka rezultuar se nga

vendi i ngjarjes është larguar me shpejtësi një automjet tip "Mercedes Benz", ku nga verifikimet rezultoi posedues shtetasi Ergys Kolaveri, vëllai i Valmir dhe Robert Kolaveri. Në momentin e kapjes së tij, ai ka qenë së bashku me shtetasin Enea Caka, kushëri i tij. Për këtë ngjarje u arrestua Ergys Kolaveri, i cili u dënua Gjakata e Krimeve të Rënda me 20 vite burg. Gjithashtu, një shpërthim me tritol ndodhi edhe në vitin 2017 në lokalin e habitit të Gazmirit, Xhelal Daci në Rrugën "Demokracia" në Kamëz, ku pati vetëm dëme materiale. Sipas ekspertëve, dyshohet se sasia e eksplozivit ka qenë më tepër se 200 gramë. Policia shoqëroi katër persona nga familja Kolaveri si të dyshuar, të cilët pas marrjes në pyetje janë lënë të lirë.

kamera sigurie, policia i sekuestroi.

Keni dyshime se kush mund të jenë personat të cilët vendosën tritolin?
Dyshojmë se autorë janë

personat me të cilët jemi në konflikt prej vitesh, me familjen Kolaveri.

Ju dyshoni se autorët janë pjesëtarë nga familja Kolaveri, me të cilët jeni

në konflikt prej vitesh. Keni pasur më herët kontakt me këtë familje për të qetësuar situatën në të cilën ndodhemi?
Në gjithë këto vite kemi

pasur kërcënime të vazhdueshme. Por jo, kontakt direkt nga familja Kolaveri nuk kemi pasur asnjëherë. Kjo është e tmerrshme, të vendoset tritol në shtëpi kur

brenda në banesë ndodhet gruaja me fëmijë të mitur, të moshës 3 dhe 4 vjeç. Nuk është dëgjuar në asnjë vend tjetër kjo gjë.

Flitet për disa sulme të kryera ndaj familjes suaj ndër vite. Çfarë masash keni marrë, u jeni drejtuar institucioneve shtetërore për mbrojtje?

Është hera e pestë që na sulmojnë. Dy herë na është vendosur tritol në shtëpi, dy herë te lokali që është biznesi i familjes sonë dhe një herë kanë tentuar të vrasin vëllain në burg. Kemi kërkuar ndihmë nga shteti, nuk na japin asnjë lloj zgjidhjeje, kemi nevojë për mbrojtje.

Ndihe mi të frikësuar nga kërcënimet e vazhdueshme, përballë faktit që ende nuk keni marrë ndihmë që kërkonin nga shteti?

Ndihe mi të kërcënuar, jemi në gjendje shumë të rënduar, në familjen tonë ka gra dhe fëmijë. Por edhe pse ndodhi sulmi, nuk mund të na detyrojnë të dalim prej shtëpisë sonë dhe të fshihe mi. Do vazhdojmë të qëndrojmë këtu duke kërkuar ndihmë nga shteti për mbrojtje, shpresoj të na ofrohet sa më shpejt.

Cila është thirrja juaj?
Konflikti me familjen Kolaveri është i hershëm, thuajse prej 3 vitesh ndodhemi në këtë situatë. Jemi në gjendje shumë të rënduar psikologjike. Kërkojmë të drejtën tonë, policia të punojë dhe të gjejë fajtorët. Të kapen autorët, ne nuk e lëmë me kaq këtë gjë.

SHPALLJE ANKANDI
Datë 31.07.2018, Ora 16:00
Shoqëria Përmbarimore "Besnik Bajraktari" sh.p.k me adresë Rr. "George W. Bush", Pallati "Kasmi", Zyra 107, Tiranë. Tel. 404506426, Cel. 067 201 9460/ 068 904 9202, e-mail: besnik.bajraktari@gmail.com.
Shpall ankandin e dytë për pasurinë e paluajtshme të debitorit Muharrem Hysen Greca.
Banesë dykateshe me sipërfaqe totale 333.16 m², e ndodhur në zonën kadastrale 8190, Vite/dokidarur pranë Drajtosit së ALIUZNI Tiranë Jug me nr. 426 datë 26.08.2006, adresë: Rruga "3 Vite/zërit Kondi", Tiranë.
Çmimi fillestar i ankandit të dytë është në shumën 4 311 075 (katër milion e treqind e njëmbëdhjetë mijë e shtatëdhjetë e pesë) lekë.
Ankandi do të zhvillohet në ambientet e Shoqërisë Përmbarimore "Besnik Bajraktari" sh.p.k me adresë: Rr. "George W. Bush", Pall. Kasmi, Zyra 107, Tiranë.

SHPALLJE ANKANDI
Datë 01.08.2018, Ora 16:30
Shoqëria Përmbarimore "Besnik Bajraktari" sh.p.k me adresë Rr. "George W. Bush", Pallati "Kasmi", Zyra 107, Tiranë. Tel. 404506426, Cel. 067 201 9460/ 068 904 9202, e-mail: besnik.bajraktari@gmail.com.
Shpall ankandin e dytë për pasurinë e paluajtshme të debitorit shoqëria "ALSION" sh.p.k.
"Njësi" me sipërfaqe 300 m², nr i pasurisë 15/392-N1, zona kadastrale 8523, vol. 38, faqe 4, adresë: Luga "Sjryrë Dyqjerr", Elbasan.
Çmimi fillestar i ankandit të dytë është në shumën 25 200 000 (njëzet e pesë milionë e dyqind mijë) lekë.
Ankandi do të zhvillohet në ambientet e Shoqërisë Përmbarimore "Besnik Bajraktari" sh.p.k me adresë: Rr. "George W. Bush", Pall. Kasmi, Zyra 107, Tiranë.

SHPALLJE ANKANDI
Datë 01.08.2018, Ora 16:00
Shoqëria Përmbarimore "Besnik Bajraktari" sh.p.k me adresë Rr. "George W. Bush", Pallati "Kasmi", Zyra 107, Tiranë. Tel. 404506426, Cel. 067 201 9460/ 068 904 9202, e-mail: besnik.bajraktari@gmail.com.
Shpall ankandin e dytë për pasurinë e paluajtshme të debitorit shoqëria "VIGAND Konstruktion" sh.p.k.
"Njësi" me sipërfaqe 265.22 m², nr i pasurisë 8/440-N12, zona kadastrale 8150, vol. 47, faqe 208, adresë: Rruga "Petro Nini Luarasi", Tiranë.
Çmimi fillestar i ankandit të dytë është në shumën 237 637 (dyqind e tridhjetë e shtatë mijë e tridhjetë e shtatë) EUR.
Ankandi do të zhvillohet në ambientet e Shoqërisë Përmbarimore "Besnik Bajraktari" sh.p.k me adresë: Rr. "George W. Bush", Pall. Kasmi, Zyra 107, Tiranë.

Drejtori i Zjarrfikësës: Kemi gati planin e masave për stinën e verës

Ina Allkanjari

Tirana nuk mund të preket nga situata katastrofike nga zjarret si Athina. Zjarret në kryeqytet nuk mund të ndodhin vetvetiu. Shkaktohen nga pakujdesia, ose janë të qëllimshme. Ne kemi një plan të detajuar masash". Kështu u shpreh drejtori i Mbrojtjes nga Zjarri dhe Shpëtimi, Bashkia Tiranë, Shkëlqim Goxhaj. Pas situatës tragjike që përfshiu territorin e Athinës në zonat verilindore, ku një zjarr i përmasave të mëdha shkaktoi mbi 80 viktimë, në një intervistë ekskluzive për "Gazeta Shqiptare", Goxhaj na tregon se sa është i kërcënuar nga zjarret kryeqyteti. "Kryeqyteti i ka mundësitë t'i përballojë këto situata, sepse kemi stacione në të gjithë periferitë e Tiranës. Ne jemi 116 zjarrfikës të ndarë në 6 stacione. Kemi stacion në Kinostudio, në Qytet Studenti, te Tuneli në Kërrabë, në Kombinat, në Institutin Bujqësor, gjithashtu edhe tek "21-Dhjetori", që është stacioni qendror. Kemi punonjës të shërbimit zjarrfikës që janë të angazhuar 24 orë", u shpreh Goxhaj. Me tej ai theksoi se janë pezulluar të gjitha lejet për punonjësit e zjarrfikësës, konkretisht nga 1 gushti deri më 15 shtator të gjithë do të kalojnë në gatishmëri të plotë.

Duke marrë shkas nga situata tragjike në Athinë, sa i përgatitur është shërbimi zjarrfikës në rastin e një situatë të ngjashme në Tiranë?

Në Tiranë nuk ndodhin situata të ngjashme me përmasa të tilla, sepse në Greqi rrymat detare rritën shpejtësinë e zjarrit. Në Tiranë kemi kushte të tjera. Kemi muaj që po punojmë për të përgatitur mjetet dhe njerëzit për stinën e verës. Fillimisht i besojmë shumë parandalimit të këtyre ngjarjeve dhe për këtë arsye kemi organizuar takime me të gjithë drejtuesit e njëjësive administrative të Bashkisë së Tiranës, për t'u kërkuar atyre që të sensibilizojnë qytetarët që të tregohen shumë të kujdesshëm gjatë kësaj stine, që mos të kemi zjarrvënje të qëllimshme ose nga pakujdesia. I kemi kushuar shumë rëndësi parandalimit të ngjarjeve.

A ka Tirana infrastrukturën e nevojshme për ndërhyrje të shpejtë në raste emergjente?

Shërbimi i zjarrfikësit të Tiranës është shërbim urban dhe është i ndarë në 6 stacione. Kryeqyteti i ka mundësitë t'i përballojë këto situata, sepse kemi stacione në të gjithë periferitë e Tiranës. Kemi stacion në Kinostudio, në Qytet Studenti, te Tuneli në Kërrabë, në Kombinat, në Institutin Bujqësor, gjithashtu edhe tek "21-Dhjetori", që është stacioni qendror. Kemi punonjës të shër-

Frika nga zjarret, Goxhaj: Jemi të përgatitur për çdo lloj situatë

"Nga pakujdesia ose të qëllimshme, zjarret në Tiranë nuk ndodhin vetvetiu"



Drejtori i Mbrojtjes nga Zjarri dhe Shpëtimi, Bashkia Tiranë, Shkëlqim Goxhaj

SHËRBIMI I ZJARRFIKËSIT

Shërbimi i zjarrfikësit të Tiranës është shërbim urban dhe është i ndarë në 6 stacione. Kryeqyteti i ka mundësitë t'i përballojë këto situata, sepse kemi stacione në të gjithë periferitë e Tiranës. Kemi stacion në Kinostudio, në Qytet Studenti, te Tuneli në Kërrabë, në Kombinat, në Institutin Bujqësor, gjithashtu edhe tek "21-Dhjetori", që është stacioni qendror.

bimit zjarrfikës që janë të angazhuar 24 orë. Në raste zjarri ne marrim koordinatat dhe punonjësit e zjarrfikësve që mbulojnë atë zonë kanë informacione për çdo rrugë dhe rrugicë. Për banesat gjithmonë është ofruar zgjidhje, sepse i kemi forcat dhe mundësitë, ndërhyrja nga ajri vjen vetëm në raste të zjarreve me përmasa të mëdha në zonat malore me

pyje dhe shkurre. Për përballimin e situatës së verës ne bashkërendojmë punën edhe me drejtori të tjera, siç është Drejtoria Pyjore, Drejtoria e Emergjencave Civile e Bashkisë Tiranë, Forcat e Armatosura në rastet madhore etj.

Sa është numri i zjarrfikësve dhe i punëtorëve dhe a janë të trajnuar për situatë të tilla?

Ditën e sotme (dje) ishim

në një njësi administrative ku organizuam një demonstrim në zonën e Vaqarrit, por përherë organizojmë trajnime dhe demonstrime për të përballuar situatë të tilla dhe mendojmë se jemi të përgatitur. Ne jemi 116 zjarrfikës të ndarë në 6 stacione. Për periudhën gusht deri në mes të shtatorit me kërkesën time dhe me urdhrin e kryetarit janë

MASAT

Planin e masave ne e hartojmë para fillimit të stinës së verës. Ky plan masash hartohet nga kryetari i Bashkisë së Tiranës. Kemi një plan shumë të detajuar dhe jemi të përgatitur për çdo lloj situatë. Kemi kapacitete njerëzore dhe mjete e pajisje për të përballuar këto situata. Edhe në qoftë se do kemi raste madhore, futen në bashkëpunim edhe drejtoritë e tjera.

lematike në Tiranë dhe cilat janë shkaqet kryesore të zjarreve?

Shkaqet kryesore të zjarreve janë nga pakujdesia, nga vetë dora e njeriut. Ndaj ne u kërkojmë qytetarëve që të tregohen shumë të kujdesshëm gjatë kësaj stine që mos të kemi zjarrvënje nga pakujdesia ose të qëllimshme. Sepse zjarret në kryeqytet nuk mund të ndodhin vetvetiu. Të gjitha njësitë administrative në territor në të cilat ka pyje, shkurre e kullota janë të rrezikuara nga zjarret në stinën e verës. Nuk mund të përcaktojmë një zonë specifike që klasifikohet si problematike.

Mund të na përmendni një ngjarje në kryeqytet ku jemi prekur nga zjarri dhe si ka qenë ndërhyrja?

Kemi rastin e magazinës në zonën e Kasharit, ku u vu shumë në dukje dhe bashkëpunimi me institucionet e tjera. Patëm ndihmë nga Drejtoria e Shërbimit Zjarrfikës së Vorës, nga ushtria, nga Policia e Shtetit nga ndërmarrja e ujësllësit. Shumë institucione bashkë bënë të mundur eliminimin në pak orë të një zjarri masiv, pasi u përfshi e gjithë fabrika në zjarr dhe ishin materiale plastike shumë të djegshme dhe mund të vazhdonin edhe me ditë të tëra në qoftë se organizimi i punës nuk do të ishte i tillë.

manovruar edhe lejet. Janë ndaluar të gjitha lejet që punonjësit të jenë në Tiranë për çdo rast emergjencë.

A ka shërbimi zjarrfikës një plan masash për çdo rast, qoftë ky edhe katastrofik?

Patjetër, planin e masave ne e hartojmë para fillimit të stinës së verës. Ky plan masash hartohet nga kryetari i Bashkisë së Tiranës. Kemi një plan shumë të detajuar dhe jemi të përgatitur për çdo lloj situatë. Kemi kapacitete njerëzore dhe mjete e pajisje për të përballuar këto situata. Edhe në qoftë se do kemi raste madhore, futen në bashkëpunim edhe drejtoritë e tjera.

Cilat janë zonat më prob-

Vetingu, në "sitë" drejtuesi i Prokurorisë së Tiranës

Rreshka, akuza për ILDKP: Raport i njëanshëm, i kam hetuar kur drejtoja Krimet e Rënda

Drejtuasi i Prokurorisë së Tiranës, Dritan Rreshka, u njoh ditën e djeshme me rezultatet e hetimit të kryer ndaj tij nga institucioni i vetingut. Në raportin e trupës gjyqësore thuhet se ILDKP-KI raportonte se subjekti ka probleme sa i përket justifikimit të pasurisë.

Prokurori i Tiranës, Dritan Rreshka e konsideroi të njëanshëm raportin e ILDKP. Në 2015, kur drejtonte Prokurorinë për Krime të Rënda, ai deklaroi se ka hetuar zyrtarë të këtij institucioni për veprat penale të korrupsionit dhe shpërdorimit të detyrës. Përgjatë 40

SEANCA

Përgjatë 40 minutave, prokurori i karrierës renditi të gjitha provat si vërtetime bankare, të Institutit të Sigurimeve Shoqërore dhe të Zyrës së Tatim-Taksave, përmes të cilave tentoi të bindte komisionin se pasuritë që disponon janë të ligjshme.

minutave, prokurori i karrierës renditi të gjitha provat si vërtetime bankare, të Institutit të Sigurimeve Shoqërore dhe të Zyrës së Tatim-Taksave, përmes të cilave tentoi të bindte komisionin se pasuritë që disponon janë të ligjshme. Ai tha se të ardhurat e tij rrjedhin nga puna në emigracion, an-

gazhimi për vite me radhë në një organizatë amerikane, paga si prokuror, të ardhurat nga Shkolla e Magjistraturës dhe qiratë. Rreshka u shpreh se ka qenë korrekt në deklarime dhe se ka paguar çdo detyrim ndaj shtetit. Si ekspert i nivelit të lartë të reformës, Rreshka deklaroi se nuk është ndjerë



Drejtuasi i Prokurorisë së Tiranës, Dritan Rreshka

aspak mirë që ILDKPKI nuk ka marrë në konsideratë asnjë provat e paraqitura prej tij. Pasi dëgjoi pretendimet e subjektit të rivlerësimit, kryesuesja e seancës, Eleda Çiftja sqaroi publikisht se komisioni nuk ka aspak qëllim të hedhë baltë mbi figurën e askujt dhe se çdo

provë e paraqitur prej prokurorit do të shqyrtohet nga trupa gjyqësore. Në përfundim, Dritan Rreshka kërkoi konfirmimin në detyrë, me qëllim që të vijojë të japë kontributin e tij në sistemin e drejtësisë. Vendimi për të pritet të shpallet më 31 korrik.

Tetë akse rrugore ko mbëtare dhe të ra jonit jugor do të pajisen së shpejti me sinjalistikë rrugore bashkëkohore. Autoriteti Rrugor Shqiptar ka hapur procedurat e tenderimit për përmirësimin e sinjalistikës në këto segmente rrugore, ku fondi limit i përcaktuar për këtë investim kap vlerën e 249.9 milionë lekë. Konkretisht, do të përmirësohet sinjalistika në akset: Përmet-Carshovë-3 urat (Dogana), Fier-Ballsh, Poshnje (Berat)-Roskovec, Këlcyrë-Përmet, Voskop-Voskopojë, Zemblak-Liqenas-Gorica (Dogana), Cermë (Lushnje)-Divjakë, Boboshticë-Dardhë. "Nga ekzaminimet e kryera, problematike në këto akse

ARRSH/ Fondi limit i investimit arrin 249.9 milionë lekë

Ja 8 akset rrugore që do të kenë përmirësim sinjalistike, hapet tenderi

AKSET KU DO TË PËRMIRËSOHET SINJALISTIKA:

- Përmet-Carshovë-3 urat (Dogana)
- Fier-Ballsh
- Poshnje (Berat)-Roskovec
- Këlcyrë-Përmet
- Voskop-Voskopojë
- Zemblak-Liqenas-Gorica (Dogana)
- Cermë (Lushnje)-Divjakë
- Boboshticë-Dardhë

kanë rezultuar vijëzimet, tabelat rrugore si dhe barrierat metalike. Nisur nga kjo, ndërhyrjet parashikojnë aplikimin e vijëzimeve në të gjithë gjatësinë e rrugëve të përfshira në projekt, vendosjen e barrierave si dhe tabelave detyruese, treguese dhe paralajmëruese", -shkruan "Scan". Po ashtu, krahas tyre do të bëhet gjithashtu edhe vendosja e elementëve të tjerë shtesë të sigurisë rrugore. Përmirësimi i sinjalistikës është një



ndër elementët kyç të planit të strategjisë kombëtare të sigurisë rrugore për t'i afruar objektivit të vendosur për vitin 2020 për reduktimin e aksidenteve rrugore. 27 gusht 2018 është edhe afati i fundit për dorëzimin e ofertave nga operatorët ekonomikë, ndërsa grafiku i punimeve parashikon një kohështrirje prej 9 muajsh.

Fletorja Zyrtare/ Dy komponentët kryesorë për dhënien e ndihmës, sa do të jenë reduktimet

Vendimi, autorizohet ndihma shtetërore për skemën fiskale në turizëm

Ja çfarë do të përfitojnë hotelet me status special

Voltiza Duro

Ditën e djeshme ka hyrë në fuqi vendimi për autorizimin e ndihmës shtetërore "Për skemën e incencitivave fiskale në sektorin e turizmit" pas propozimit të komisionit me në krye ministrin e Financave dhe Ekonomisë, Arben Ahmetaj. Dhënësit e ndihmës kanë miratuar me akte ligjore dhe nënligjore dhënien e incencitivave fiskale, me qëllim mbështetjen e aktivitetit ekonomik të shërbimit të akomodimit në strukturat akomoduese, si edhe hoteleve me "status special", vendës dhe të huaj. E gjithë kjo ka si synim mbështetjen e aktivitetit ekonomik të ndërmarrjeve në Shqipëri, në sektorin e turizmit. "Komisioni vlerëson se incencitivat fiskalë janë ndihmë shtetërore. Ky konkluzion paraprak mbështetet në gjetjet, se: - përjashtimi nga tatimi mbi fitimin për kohëzgjatjen prej 10 vitesh; përjashtimi nga taksa mbi ndërtesat; aplikimi i shkallës së reduktuar të Tatimit mbi Vlerën e Shtuar nga 20% në 6%, për çdo furnizim shërbimi të ofruar brenda strukturave akomoduese 'hotel/resort me pesë vje, status special'; si edhe aplikimi i shkallës së reduktuar të Tatimit mbi Vlerën e Shtuar nga 20% në 6%, për çdo furnizim shërbimi të ofruar nga strukturat akomoduese, do t'u japë përfituesve të ndihmës një avantazh ekonomik që nuk ofrohet në treg, në kushte normale", - theksohet në Fletoren Zyrtare. Në këtë të fundit më tej bëhet me dije se avantazhi i dhënë është selektiv, sepse vetëm përfituesit/ndërmarrjet do të përfitojnë nga skema e ndihmës dhe ai jepet nga burimet shtetërore, duke qenë se lehtësirat do të rezultojnë në uljen e të ardhurave tatimore në buxhetin e shtetit dhe lehtësirat fiskale të dhëna për ndërmarrjet kanë efekt në



Miratohet krijimi i fondit të inovacionit

Komisioni i Ndhmës Shtetërore vendosi dje që autorizojë zbatimin e skemës së ndihmës shtetërore "Për krijimin e fondit të inovacionit". Kjo, pasi ndihma synon nxitjen e projekteve të inovacionit të ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme, por nga fondi i inovacionit nuk do të përfitojnë ndërmarrjet me pasqyrë financiare me humbje. "AIDA të mbështesë projektet e inovacionit për mbulimin e kostove të pranueshme: kostot për zotërimin, vërtetimin dhe mbrojtjen e patentave dhe të aseteve të tjera të paprekshme; kostot për vënien në dispozicion të personelit me kualifikim të lartë nga një organizatë kërkimi ose nga një ndërmarrje e madhe, e cila kryen aktivitete kërkimi, zhvillimi dhe inovacioni, në një funksion të krijuar rrishtazi brenda ndërmarrjes përfituese, pa zëvendësuar pjesëtarët e tjerë të stafit, si dhe kostot për këshillimet e inovacionit dhe shërbimet mbështetëse", theksohet në Fletoren Zyrtare. edhe krijimin e vendeve të reja të punës. Dhënësi i ndihmës është Ministria e Financës dhe Ekonomisë, ndër-

VENDIMET E KOMISIONIT

- Të autorizojë zbatimin e skemës së ndihmës shtetërore operacionale për ndërmarrjet që ofrojnë shërbimin e akomodimit në strukturat akomoduese dhe për ndërmarrjet që investojnë në strukturat akomoduese "me 4 ose 5 vje, me status special". -Ndërmarrjet përfituese, në kuadër të skemës ose në kuadër të ndihmës individuale, do të duhet të deklarojnë çdo formë tjetër ndihme shtetërore që kanë përfituar ose do të përfitojnë.
- Ministria e Financave dhe Ekonomisë, brenda datës 31 mars të çdo viti, të paraqesë raport për impaktin e ndihmës shtetërore gjatë vitit paraardhës financiar, si edhe të japë çdo informacion që do të kërkohej për monitorimin dhe kontrollin e ndihmës së dhënë. Të gjitha të dhënat për zbatimin e skemës të ruhen deri në dhjetë vite, pasi ndihma e fundit individuale të jetë dhënë në kuadër të kësaj skeme.
- Ministria përgjegjëse për turizmin të njoftojë dhe marrë autorizimin nga ana e Komisionit të Ndhmës Shtetërore.

Miratohet skema për mbështetjen e sipërmarrjeve të reja në treg

Ditën e djeshme Komisioni i Ndhmës Shtetërore vendosi që të autorizojë zbatimin e skemës së ndihmës shtetërore "Për krijimin e fondit në mbështetje të sipërmarrjeve të reja start-up". Kështu, ndihma lehtëson zhvillimin e veprimtarive të caktuara ekonomike, deri në atë masë sa kjo ndihmë nuk është në kundërshtim me detyrimet e marrëveshjeve ndërkombëtare të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë. AIDA duhet t'i kërkojë çdo përfituesi të ndihmës paraqitjen e një plani biznesi, i cili duhet të përmbajë këto elemente: një përshkrim të detajuar duke shpjeguar arsyet se pse ndërmarrja nuk do të mund të ushtrrohej veprimtari në treg në mungesë të ndihmës shtetërore, një plan financiar që tregon qëndrueshmërinë e biznesit pa ndihmë shtetërore pas tri vitesh, kohën e nevojshme për fillimin e veprimtarisë tregtare të biznesit, numrin e punonjësve të punësuar çdo vit gjatë kohëzgjatjes së ndihmës. Skema synon të ndihmojë ndërmarrjet e reja të vogla dhe të mesme për funksionimin e tyre në treg.

sa zbatues i skemës së ndihmës shtetërore është ministria përgjegjëse për turizmin. **PËR FITUESIT** Plani për dhënien e ndihmës shtetërore në formën e incencitivave fiskalë përbëhet nga dy komponentë. Komponenti i parë është skema e ndihmës shtetërore për furnizimin e shërbimit të akomodimit në strukturat akomoduese, në formën e reduktimit të shkallës së Tatimit mbi Vlerën e Shtuar nga 20% në 6%. Ndërkohë, komponenti i dytë është skema e ndihmës shtetërore për çdo furnizim shërbimi të ofruar brenda strukturave akomoduese "hotel/resort me pesë vje, status special", në formën e reduktimit të shkallës së reduktuar të Tatimit mbi Vlerën e Shtuar nga 20% në 6%, përjashtim nga tatimi mbi fitimin (për një kohëzgjatje prej 10 vitesh), si dhe përjashtimi nga taksa e ndërtesës. Përfituesit nga zbatimi i skemës së ndihmës shtetërore janë ndërmarrjet që ofrojnë shërbimin e akomodimit në strukturat akomoduese, si dhe operatorët menaxhues në strukturat akomoduese "me 4 ose 5 vje, status special", të cilat marrin për sipër operimin dhe menaxhimin e një strukture akomoduese me 4 ose 5 vje.

Studentët, praktika e intershipe pranë "Hysenbelliu Group". 80% punësohen menjëherë

Aurora Golemi

"Luarasi", zgjedhja më e mirë për një të ardhme të sigurt

15 vite rrugëtim akademik të një institucioni arsimor elitari

Në 15 vite rrugëtim akademik universiteti "Luarasi" ndërtoi standarde cilësie dhe përgjegjësi sociale që u kthyen në traditë, që u dhanë emrin e mirë institucionit dhe brezave, të cilët u formuan e dolën nga bankat e tij. Vit pas viti, ky institucion elitari ka arritur në rritje dhe sot është me tri fakultete: të Drejtësisë, Ekonomisë dhe të Teknologjisë së Informacionit dhe Inovacionit, duke iu përshtatur me programet e tij kërkesave dhe nevojave të tregut të punës, si lokal dhe global. Vit pas viti cilësia e studentëve të rinj ka ardhur në rritje. "Luarasi" është një ndër 4 institucionet e arsimit të lartë i vlerësuar ekselent nga Agjencia e Sigurimit të Cilësisë në Arsimin e Lartë. Rektori i "Luarasit", profesor Et'hem Ruka thotë se akreditimi i plotë dhe certifikimi për 6 vite akademike është vullë besueshmëri për opinionin publik. Me vlerësimin maksimal dhënë nga agjencia prestigjioze britanike "Quality Assurance Agency" në fushën e arsimit, "Luarasi" plotëson të gjithë tablonë e asaj çka duhet vërtet të ofrojë një institucion arsimor, që mbi të gjitha synon të mbajë lart emrin e vet dhe i drejtohet atij segmenti të studentëve, të cilët duan një arsim elitari e që kërkojnë të kenë vëmendje gjatë kohës së formimit të tyre.

KËSHILLIMI I KARRIERËS

Këtë vit "Luarasi" u angazhua fuqishëm, si asnjëherë më parë, në një fushatë intensive të këshillimit të karrierës me maturantët të qyteteve dhe fshatrave të ndryshëm, kudo në Shqipëri. Fakt është që në të gjitha gjimnazet e mëdha është ofruar këshillim cilësor karriere nga stafi akademik dhe administrativ i "Luarasit", me një pjesëmarrje të vetë rektorit Et'hem Ruka, zv.rektorëve, dekanëve, përgjegjësve të departamenteve, si dhe administratorëve të "Luarasit", duke treguar kështu një kujdes të veçantë për të ofruar më të mirën e mundshme nga i gjithë stafi drejtues. Ruka tregon se nga takimet në rang vendi për këshillimin e karrierës me stafin e tij takoi nga afër rreth 25 mijë maturantë. Mijëra gjimnazistë të fshatrave më të thella i kanë pritur me kërshëri grupet përfaqësuese të "Luarasit", pasi një gjë e tillë s'kishte ndodhur asnjëherë, nga asnjë universitet tjetër. Maturantët, pas leksioneve të hapura, kanë treguar interes të madh dhe kanë kërkuar të regjistroheshin sa më parë të "Luarasit". "Universiteti "Luarasi" si institucion i vlerave merr përsipër jo vetëm jetën dhe aktivitetet akademike, por edhe përgjegjësi sociale për të përkrahur më të talentuarit nga të gjitha shtresat dhe fushat, duke mbështetur me bursa bazar mbi parimin e meritokracisë dhe motivon nxënës dhe studentë të ekselencës që



përzgjedhin "Luarasin", tha Et'hem Ruka. Për dekanen e Fakultetit të Drejtësisë, Rezana Konomi, klima ligjore ka përfitimë të shumëfishta për njerëzit në nevojë dhe studentët, të cilët pas kësaj eksperience do të kenë profilin e tyre të juristit. Sa i takon Fakultetin Ekonomik, dekanin Mateo Spaho rendit bashkëpunimet e shumta që ka me biznesin vendës e të huaj, këtu veçohet edhe kompania globale "Procter and Gamble", e cila e ka përzgjedhur kolegjin "Luarasi" si pikë referimi për të rekrutuar në radhët e saj studentët më të shkëlqyer. Tek "Luarasi" janë diplomuar

qindra studentë për të cilët tregohet kujdes i veçantë të marrin dijet më të fundit, në mënyrë që të punësohen brenda vitit të parë pas diplomimit. Studentët janë padyshim fytyra e "Luarasit". Të ardhmen e tyre ia kanë besuar universitetit që bën diferencën. Disa janë pjesë e intershipeve në kompanitë e "Hysenbelliu Grup", ku u jepet mundësia që dijet teorike t'i vendosin në praktikë. Studentët e "Luarasit", institucioni arsimor që është pjesë e "Hysenbelliu Grup" me President zotin Irfan Hysenbelliu, mund ta quajmë veten me fat në krahasim me studentët e universiteteve të

tjera, pasi kanë një mundësi më tepër për të gjetur një punë në gjirin e gamës së gjerë me 20 kompani që ka grupi. Zyrat qendrore të "Hysenbelliu Group" kanë mirëpritur studentët të Kolegjit Universitar "Luarasi", të cilët kanë kryer praktikën mësimore. Në tregun e punës studentët e të diplomuarit në "Luarasit" janë nga më të kërkuarit, sepse politikat e universitetit janë që të ndiqet zhvillimi dhe promovimi i gjithsecilit. Statistikat e "Luarasit" tregojnë se rreth 80% e studentëve të diplomuar janë punësuar menjëherë pas përfundimit të studimeve, ndërsa të tjerë

PRAKTIKAT MËSIMORE

Zyrat qendrore të "Hysenbelliu Group" kanë mirëpritur studentët të Kolegjit Universitar "Luarasi", të cilët kanë kryer praktikën mësimore. Në tregun e punës studentët e të diplomuarit në "Luarasi" janë nga më të kërkuarit, sepse politikat e universitetit janë që të ndiqet zhvillimi dhe promovimi i gjithsecilit.

janë një tjetër komponent i rëndësishëm, që prekin direkt xhepat e familjeve shqiptare. "Luarasi" aplikon tarifën më të liria në tregun e arsimit të lartë publik për cilësinë më të mirë të mësimdhënies, vlerave dhe mundësive që ofron. Në 15 vite universiteti "Luarasi" prezantoi vlerat e një institucioni cilësor dhe elitari, që punon për krijimin e elitave të profesionistëve, duke i aftësuar dhe përgatitur për tregun e punës dhe shoqërinë. Profesor Aleks Luarasi kishte një ëndërr: Donte të themelonte një institucion arsimor elitari privat. Dhe ashtu bëri, themeloi universitetin "Luarasi", i pari institucion privat arsimor në Shqipëri. Ashu si 15 vite më parë, maturantët dhe studentët e konsiderojnë "Luarasin" si institucion i vlerave dhe mundësive. Me këto elemente dhe vlera, "Luarasi" plotëson të gjithë tablonë e asaj çka duhet vërtet të ofrojë një universitet, që mbi të gjitha synon të mbajë lart emrin e vet dhe që i drejtohet atij segmenti të rinjve që duan një arsim elitari, që kërkojnë të kenë dhe të jenë të vlerësuar dhe të përfshirë gjatë gjithë formimit të tyre në "Luarasi". "Luarasi" nisi si një ëndërr, që sot realizon ëndrrat e të rinjve për një të ardhme më të mirë dhe të sigurt.

Udhëzimi hyn në fuqi: Drejtori, përgjegjës për shpërndarjen

Tekste shkollore falas për nxënësit e klasave I-IV, kushti që duhet plotësuar

Me fillimin e vitit mësimor 2018-2019, të gjithë nxënësit e klasave I-IV të arsimit bazë do t'i përfitojnë falas tekstet shkollore, me kushtin që duhet t'i dorëzojnë sërish pas përfundimit të vitit. Udhëzimi ka hyrë në fuqi ditën e djeshme, menjëherë pas publikimit në Fletoren Zyrtare. "Gazeta Shqiptare" publikon sot listën e plotë e teksteve shkollore që do të shpërndahen falas për kategorinë e sipërpërmendur. Tekstet shkollore të klasave I-IV, të cilat janë pronë e njësive arsimore vendore, të përdoren për një periudhë kohore deri në tri vite shkollore. Njësitë arsimore vendore dhe drejtoritë e shkollave publike janë strukturat

përgjegjëse për pajisjen me tekstet shkollore në përdorim falas të të gjithë nxënësve të klasave I-IV në shkollat e varësisë, - theksohet në udhëzim. Më tej, në këtë të fundit bëhet me dije se drejtori i shkollës publike ngrë Komisionin e Administrimit të Teksteve Shkollore në përdorim falas, si strukturë që kryen të gjithë veprimtarinë e marrjes në dorëzim të teksteve shkollore, sipas porosisë së dhënë, kthimit dhe rishpërndarjes të nxënësit. Komisioni do të kryesohet nga drejtori i shkollës, ndërsa numri i anëtarëve do të përcaktohet në varësi të numrit të nxënësve për klasat I-IV në shkollë, por jo më pak se dy anëtarë. Ndërkohë, prosia të botuesi/distributori

tori do të bëhet zyrtarisht nga drejtori i shkollës, pas procedurës zyrtare të përzgjedhjes nga titujt e katalogut dhe do të konfirmohet nga drejtuesi i njësive arsimore vendore. Botuesit do të bëjnë furnizimin drejtpërdrejt në shkollë, sipas porosisë zyrtare të marrë. Furnizimi duhet të përfundojë detyrimisht 10 ditë kalendarike para datës së fillimit të vitit shkollor. Drejtori i shkollës nënshkruan faturat tatiimore të çdo furnizimi të bërë nga botuesi/distributorët, sipas sasisë së porositur. Drejtori i shkollës është përgjegjës për pajisjen në kohë me tekste shkollore të të gjithë nxënësve përfitues të regjistruar në atë shkollë.

Voltiza Duro

LISTA ME TEKSTET FALAS

KLASA I:

1. Abetare (libri i nxënësit)
2. Matematika 1 (libri i nxënësit)
3. Dituria Natyre 1 (libri i nxënësit)
4. Edukimi për Shoqërinë 1 (libri i nxënësit)

KLASA II:

1. Gjuha Shqipe 2 (libri i nxënësit)
2. Matematika 2 (libri i nxënësit)
3. Dituria Natyre 2 (libri i nxënësit)
4. Edukimi për Shoqërinë 2 (libri i nxënësit)

KLASA III:

1. Gjuha Shqipe 3 (libri i nxënësit)
2. Matematika 3 (libri i nxënësit)
3. Dituria Natyre 3 (libri i nxënësit)
4. Qytetaria 3 (libri i nxënësit)
5. Gjuha Angleze 3 (libri i nxënësit)
6. Gjuha Frënge 3 (libri i nxënësit)
7. Gjuha Italiane 3 (libri i nxënësit)
8. Gjuha Gjermane 3 (libri i nxënësit)

KLASA IV:

1. Gjuha Shqipe 4 (libri i nxënësit)
2. Matematika 4 (libri i nxënësit)
3. Dituria Natyre 4 (libri i nxënësit)
4. Qytetaria 4 (libri i nxënësit)
5. Historia 4 (libri i nxënësit)
6. TIK 4 (libri i nxënësit)
7. Gjuha Angleze 4 (libri i nxënësit)
8. Gjuha Frënge 4 (libri i nxënësit)
9. Gjuha Italiane 4 (libri i nxënësit)
10. Gjuha Gjermane 4 (libri i nxënësit)

GJIROKASTËR - Gjykata e Shkallës së Parë në Gjirokastrë ka vendosur dje masën e sigurisë "Arrest me burg" ndaj Lulzim Kullës, i njohur si i "forti" i Shkodrës. Ai u arrestua pak ditë më parë në Kakavijë, pasi tentoi që të kalonte në Greqi me një pasaportë të falsifikuar. Lulzim Kulla rezultoi se në korrik të vitit 2014 është pajisur me një pasaportë me të dhëna të falsifikuara. 43-vjeçari ka aplikuar me shenjat e gishtërinjve dhe fotografinë e tij, por me



Arrestuari Lulzim Kulla

Rezultoni i dënuar me 12 vite burg për drogë në Itali

Tentoi të ikte në Greqi me pasaportë false, gjykata lë në burg "të fortin" e Shkodrës, Lulzim Kulla

emrin Alfons Deda, për pasaportë në Durrës, duke përdorur kështu identitetin e një personi tjetër. Pasi Kulla ka tërhequr pasaportën, nga verifikimet e kryera ka rezultuar se të dhënat e tij nuk përkojnë me identitetin e dhënë. Në seancën e djeshme, avokati i tij kërkoi një masë më të

lehtë, pasi sipas tij, Kulla e kishte marrë në mënyrë të pavullnetshme pasaportën false. Ndërkaq, prokurori Arben Pasho i ka nxjerrë një dënim me 12 vite burg Kullës në Breshia të Italisë për trafik droge dhe krijim të organizatave kriminale. Sipas informacioneve nga policia, ai rezultoi se ka

vuajtur vetëm 3 vite burg në Itali, ndërsa ishte në kërkim nga shteti fqinj. Lulzim Kulla u vu në qendër të vëmendjes së publikut në janar të këtij viti, kur u bë objekt i një atentati me tritol në gytetin e Shkodrës. Rreth 500 gr C4 u vendos në një motoçikletë të parkuar afër fuoristradës së tij, ndër-

sa shpërthimi i shkaktoi dëgjje në 25 për qind të trupit. Në atë kohë, Kulla deklaroi për policinë se nuk i njihje autorët dhe nuk kishte dyshime se kush mund ta kishte vendosur tritolin. Ai njihet edhe për shkak të së kaluarës së tij, pasi emri i tij lidhet me disa ngjarje kriminale, por që në fund nuk është dënuar. 43-vjeçari ka pasur dalje të rralla, ndërsa tentoi të kalonte kufirin me identitet të rremë pa qenë në dijeni se prej 4 vitesh identiteti i vjedhur ishte pjesë e sistemit TIMS.

Policia: Koka e grupit kriminal, Gazmend Garupi. Ja roli i pjesëtarëve të tjerë

Trafikonin klandestinë në Angli dhe SHBA, arrestohen 9 persona dhe 2 në kërkim

Pagesa për bandën e falsifikatorëve, 8-12 mijë euro, realizonte martesë fiktive me shtetas bullgarë

Senad Nikshiqi

SHKODËR

Një grup kriminal që trafikonte klandestinë shqiptarë në SHBA dhe Angli kundrejt pagesave që varionin nga 8 mijë deri në 12 mijë euro është shkatërruar nga policia e Shkodrës. Blutë në bashkëpunim me prokurorinë dhe Drejtorinë e Forcës Operacionale finalizuan me kujdes operacionin e koduar "Garantuesit", duke vënë në pranga 9 persona, ndërsa dy të tjerë janë shpallur në kërkim. Mësohet se grupi në fjalë mundësonte trafikun e klandestinitëve përmes falsifikimit të pasaportave, kartave të identitetit italiane dhe greke, viza, leje drejtimi, karta studenti etj., dhe nga përdorimi i tyre mundësohej kalimi drejt Amerikës dhe Anglisë. Finalizimin e këtij operacioni e bëri të ditur përmes një deklaratë për shtyp drejtori i Policisë Vendore të Shkodrës, Vehbi Bushati. "Gjatë operacionit u arrestuan 9 shtetas dhe janë shpallur në kërkim 2 të tjerë, të cilët vepronin si një grup i strukturuar kriminal, që merrej me trafik personash drejt Anglisë dhe SHBA, nëpërmjet një skeme që funksiononte në bazë të falsifikimit të dokumenteve të ndryshme të identitetit", bëri të ditur drejtori Bushati. Pas arrestimit të 9 shtetasve dhe shpalljes në kërkim të dy të tjerave, policia ka sekuestruar gjithashtu një laborator që shërbente për falsifikimin e dokumenteve si dhe prova të shumta materiale të kësaj skeme trafiku. Sipas burimeve të mësipërme, personat e arrestuar dyshohen se kanë konsumuar elementët e veprave penale si: "Ndhimë për kalim të paligjshëm të kufirit", "Prodhim i mjeteve për falsifikim të dokumenteve", "Falsifikim i vulave dhe stampave ose formulave", "Falsifikim i letërnjoftimeve pasaportave ose vizave", "Falsifikim i dokumenteve shkollore" dhe "Prodhim e shitje narkotikësh". Po të njëjtat



Materialet e sekuestruara gjatë operacionit të koduar "Garantuesit"

ITENERARI

Trafiku klandestin bëhej në dy rrugë. Njëra rrugë ishte: Shqipëri-Sicili-Itali-Maltë-Angli. Ndërsa, tjetra ishte: Shqipëri-Kosovë-Kroaci-Itali-Maltë-Angli-SHBA. Po kështu, këta shtetas u ofronin personave të interesuar kundrejt pagesës shoqërimin e tyre deri në destinacionin final si dhe realizonin martesë fiktive me shtetase dhe shtetas bullgarë nëpër zyra të ndryshme të Gjendjes Civile të Shqipërisë.

burime pohuan se grupi kriminal realizonte martesë fiktive me shtetase dhe shtetas bullgarë nëpër zyra të ndryshme të Gjendjes civile të Shqipërisë për t'u pajisur me dokumente, ndërsa më pas i shoqëronin deri në destinacionin final. Kreu i grupit ishte Gazmend Garupi, ndërsa Sotirajq Antoni dhe Haxhi Ramadani ishin bashkëpunëtorë.

PAGESAT PËR TRAFIKANTËT

Arrestimi i tyre është bërë në kuadër të procedimit

penal të vitit 2018, pasi nga tërësia e veprimeve hetimore të kryera rezultoi se ky grup i mirorganizuar kryente veprimtari kriminale në drejtim të dhënies ndihmë për kalim të paligjshëm të kufirit drejt vendeve të Bashkimit Europian dhe SHBA-ve. Këto veprime bëheshin kundrejt pagesës së shumave të ndryshme që varionin nga 8.000 euro deri në 12.000 euro. Ndhimja e ofruar konsistonte në falsifikimin e dokumenteve në vendet e

PERSONAT E ARRESTUAR DHE ROLET NË GRUP

1. Gazmend Garupi, 44 vjeç, banues në fshatin Kosmaç, Shkodër. Ky shtetas ishte në rolin kryesor, atë të organizatorit.
2. Sotirajq Antoni, 52 vjeç, banues në Korçë, në rolin e bashkëpunëtorit kryesor, pasi siguronte të gjitha dokumentet e falsifikuara në vendet e BE-së dhe në Shqipëri.
3. Haxhi Ramadani, 54 vjeç, banues në Kosmaç, Shkodër, në rolin e bashkëpunëtorit.
4. Bleđjan Ramadani, 29 vjeç, banues në Kosmaç Shkodër, në rolin e ndihmësit.
5. Eduart Shima, 37 vjeç, banues në Shkëzëz, Shkodër në rolin e rekrutuesit.
6. Pllumb Pali, 47 vjeç, banues në Gruemirë, Malësi e Madhe. Siguronte dokumente të falsifikuara (falsifikator).
7. Shpëtim Kiri, 59 vjeç, banues në Shkodër dhe Korçë, në rolin e transportuesit dhe ndihmësit.
8. Nikolla Mano, 59 vjeç, banues në Korçë, banesa e tij përdorej si bazë dhe kishte një laborator për falsifikimin e dokumenteve.
9. Tonin Shtjefni, 27 vjeç banues në Lezhë, përfitues dhe përdorues i dokumenteve të falsifikuara.

PERSONAT E SHPALLUR NË KËRKIM

1. K.P., 46 vjeç, banues në Lezhë, në rolin e ndihmësit pasi ndërmjetësonte martesat fiktive me shtetase bullgare.
2. Y.Th. 36 vjeç, banues në Kosmaç, Shkodër, i shpallur në kërkim për "Ndhimë për kalim të paligjshëm të kufirit", dhe "Prodhim e shitje narkotikësh".

origjinës shtete të BE-së, ku këta shtetas në bashkëpunim me njëri-tjetrin mundësonin gjetjen e personave dhe më pas pajisjen e tyre me dokumente të falsifikuara (karta identiteti italiane dhe greke, viza, leje drejtimi, karta studenti etj.) dhe nga përdorimi i tyre mundësohej kalimi për në Angli dhe SHBA.

LABORATORI I SEKUESTRUAR

Kreu i policisë së Shkodrës, Vehbi Bushati deklaroi në përfundim të operacionit janë sekuestruar në cilësinë e provës materiale një laborator për falsifikimin e dokumenteve, në të cilin u gjetën: 3 njësi kompjuteri, 2 laptopë, 5 skanera, 5 printera, 3 printer-skanner, 5 vula të ndryshme; 14 USB, 17 tamponë vulash, 1 pasaportë biometrike, 1 kartë identiteti, 10 platforma me strukturë plastike, 2 karta identiteti të huaja, fotografi pasaportash, materiale kancelarie të ndryshme, lëndë narkotike e dyshuar kanabis sativa 2 kg,

4 telefona celularë, 4 automjete të markave të ndryshme dhe 1 armë gjahu. Ky është rasti i tretë brenda këtij viti i goditjes së këtyre grupeve kriminale që merren me trafikimin e shtetasve të ndryshëm. Rreth 40 persona u arrestuan në muajin mars të këtij viti ndërsa 17 të tjerë u arrestuan në muajin maj të po këtij viti, mes të cilëve edhe disa nga Shkodra. Ky është grupi i tretë që goditet brenda pak kohësh nga Policia e Shtetit.

BOTIMI


Nga Grezda te Gjergo e Dule, kolegët që spiunuan Maks Velon

Dosja sekrete e përndjekjes, hetimit dhe dënimit të Maks Velos ka ardhur në një libër me titullin "Maks Velo. Jetë paralele" përgatitur nga Alda Bardhyli dhe nën logon e 'UET PRESS'. Libri pati promovimin të premtën në orën 13:00 në UET. Në kuadër të debateve mbi të shkuarën, është hera e parë që publikohet dosja e përndjekjes së një artisti gjatë regjimit komunist. Janë 106 dokumente, një pjesë e të cilave shoqërohen me rrëfime të vetë Velos mbi ngjarjet e raportura. "Dosja 'Velo' pritet të hapë debatin e munguar mbi rolin që artet dhe kultura ka pasur gjatë regjimit komunist", tha dje Bardhyli. Ajo njoftoi se në këto dosje ka emra artistësh të njohur të artit që kanë spiunuar e kanë qenë pjesë e aparatit të Sigurimit të Shtetit. "Unë mendoja se kisha shokë e artistë. Ata ishin përbindës. Unë shkova të ngushëlloja Safon se i kishin arrestuar djalin, ajo ia tha të gjitha sigurimit. Të njëjtët artistë janë edhe sot", tha Velo gjatë promovimit ku mori pjesë edhe Genta Mara Sula nga Autoriteti i Dosjeve. "GSH" po boton pjesë nga libri dosjen e Velos dhe me një parathënie e bisedë me Alda Bardhylin.

DOKUMENTI 6 "SEKRET"

Shënim operativ sot më datë 04.03.1975 pata një bisedë me piktorin stazhier të Institutit të Arteve, Genc Hajdari. Biseda u zhvillua rreth piktorit Maks Velo, për të cilin Genci na ka denoncuar disa gjëra në vitin 1973. Duke folur për këtë çështje Genci tha: "Maksi u kam pasur pedagog këto kohë. Më kujtohet që në leksionet që na jepte Maksi në atë kohë, ai na citonte me zell e pasion të madh citate të filozofëve reacionarë si: Dideron, Pikaso etj. Për të na dhënë citatet e këtyre filozofëve, Maksi ishte gati të humbiste gjithë kohën e leksionit. Për sa i përket krijimtarisë së tij si piktor, Maksi ka qenë një formalist i theksuar. Ai lexonte mirë frëngjisht e anglisht dhe meqenëse dinte këto gjuhë lexonte shumë literaturë të huaj, të cilën e merrte në Bibliotekën Shkencore të UT-së. Maksi në këtë kohë kishte shoqëri me piktorin Fatmir Mati etj. Këta të gjithë shkëmbenin me njëri-tjetrin materialet në gjuhë të huaj që lexonin dhe që i merrnin nga drejtori i Bibliotekës Shkencore të UT-së. Shoqëri shumë kohë përpara Maksit ka pasur dhe me skulptorin Hektor Dule. Në kohën që Hektori u kthye nga Çekosllovakia, hynte e dilte në shtëpinë e Maks Velos, por pastaj u prishën me njëri-tjetrin

Dokumentet/ Del dosja dhe deponimet e miqve të arkitektit në hetuesi



1975/ Hektor Dule: Nuk flas me të, më ka ngacmuar motrën, është i ligë

dhe që nga ajo kohë e deri më sot nuk shkojnë me njëri-tjetrin. Shkakun e prishjes së tyre, unë nuk e di. Maksi ka qenë një njeri i dhënë pas femrave. Më kujtohet se njëherë Maksi i ka propozuar një shoqësi studente që kjo t'i shkonte në shtëpi dhe t'i vizitonin studion e tij. Këtë vajzë Maksi i simpatizonte. Kam marrë vesh që Maksi ka një ose dy vite që është martuar me një femër që ka një baba të mirë, profesor, por që janë femra të degjeneruara si e ëma e saj (e cila është franceze me origjinë) ashtu edhe vetë kjo. E shoqja e Maksit ka qenë e fejuar me një tjetër, por e ndau atë dhe mori Maks Velon". Biseda me Gencin u zhvillua nga unë dhe shefi, shoku Ilo Noti.

Punëtori operativ/ Ropi Postolli/

DOKUMENTI 9 "SEKRET" / Tiranë, më 23.01.1975

IMPLIKIM NJJERRË NGA PROCESI I TË ARRESTUARIT EDISON GJERGO, DATË 21.01.1975,

... Për pikturen 'Epika e yjeve të mëngjesit' që më kritikoi me të

por unë nuk shkova t'i merrja dhe nuk ia kam marrë. Maksit atë ditë i pashë që kishte bërë edhe piktura me ndikime nga këta autorë dhe unë ia lavdërova duke e inkurajuar atë". Punëtori Operativ/Piro Katro

DOKUMENTI 14 SEKRET

Tiranë, më 02.09.1975

Sot më datë 27.07.1975 u takova në studion e tij me skulptorin Hektor Dule. Pasi bisedova për krijimtarinë e tij në fushën e skulpturës (pasi Hektori ka një krijimtari pozitive dhe partishmëri e taban kombëtar) e pyeta atë për kolegun e tij Maks Velo, për të cilin e dija që Hektori e ka pasur shok para dy-tri vitesh, por janë zënë me të dhe tani nuk flasim. Për Maks Velon, Hektori më tha këto gjëra: "Maks Velo është tip borgjezi, njeri i lig. Unë me të kam punuar në Komitetin Ekzekutiv të Tiranës dhe kam pasur njëfarë njohjeje, por jemi zënë dhe tani nuk flasim. Shkaku i zënies sonë ka qenë sepe ai ka tentuar të kapë njëherë motrën time me dorë, në kohën kur kjo ka ardhur të më kërkonte mua në Komitet. Në atë kohë, Maksi ka bërë pjesë në rrethin shoqëror të Fadil Paçramit, Ibrahim Uruçit, V.K. dhe I. K., dhe mbahej afër nga Fadil Paçrami. Në vitin 1962, kur kisha gati një vit që isha kthyer nga Çekia, i kam shkruar për herë të parë për vizitë Maksit në shtëpi, me ftesën e tij. Kur vajta në shtëpi vura re se aty kishte një luks të madh dhe binte erë ambient komplet borgjez. Për sa i përket krijim-



tarisë artistike të Maksit, ai është njeri 'snob' (i paaftë), por që do të tregohet se është i zoti në pikturë dhe arkitekturë. Më kujtohet mirë se kur është bërë diskutimi i veprave me rastin e 30-vjetorit të Çlirimit, Maks Velo ka bërë një diskutim shumë të poshtër... Në vitin 1971 '72 Maksi mori përsipër të bënte disa punime arkitektonike për hotel 'Vollgën' (Drinin). Vizatimet i kishte bërë vetë, ndërsa punimet në bronz apo argjend ia bëri punëtori i ndërmarrjes artistike 'Migjeni', Nasi Buraci. Në komisionin e vlerësimit të këtyre objekteve isha edhe unë dhe nuk i pranuan asnjë, sepse që të gjitha ishin

Ka një sërë dokumentesh në të cilat Maks Velo akuzohet çështje morali, duke përmendur raportet e tjera personale me gra të huaja që ai i takonte në Shqipëri. Më poshtë, pjesë dokumentesh.

DOKUMENTI 18 Tiranë, më 17.02.1976

Relacion përmbledhës mbi materialet e objektit në 2/A Maks Velo (PJESE)

Maksi ka qenë martuar me Luçiana Naraçi, e cila e ka të ëmën austriake. Me këtë grua Maksi ka lindur një djalë. Ka më se një vit që ata nuk shkojnë mirë me njëri-tjetrin dhe puna ka shkruar në gjyq për t'u ndarë. Maksi është tip shumë negativ. Ai është takuar disa herë me turistë të huaja

franceze e gjermane në plazhin e Durrësit për të kryer me të marrëdhënie seksuale. Maksi njihet si një njeri feminist. Ai është dhe tip psikopati, por kjo nuk do të thotë se veprimet armiqësore që ai kryen i bën në mënyrë të pandërgjegjshme...

DOKUMENTI 21 Ekzemplar i vetëm/ NYS-RET DAUTAJ/ Tiranë, më 10.07.1976

Unë p. operativ Ropi Postoli, efektivi i Drejtorisë së Punëve të Brendshme Tiranë, pasi studiova materialet e dosjes në ngarkim të objektit në 2/A Maksim Velo. Vetë Maksi njihet si njeri i shturur në jetë e imoral. Qëndrimi i tij moralo-politik që nga koha që ka qenë në shkollën e mesme, në atë të lartë dhe gjatë kohës që ka punuar në ndërmarrje dhe institucione të ndryshme nuk ka qenë i mirë. Maks Velo

Vjehrra e akuzoi për dhunë, bashkëshortja: U ndamë për qëndrime të huaja karshi gruas

Cili qe roli i familjes në dënimin e Maks Velos? Ai ishin çështjet morale apo rrymat artistike që përkrahte që e dënuan Maks Velon? Jeta e arkitektit e piktorit vjen e rrefyer në një libër që përmban dosjen e plotë të Sigurimit të Shtetit për të: nga sherret me miqtë, te bisedat për artin e huaj, apo marrëdhënien me femrat dhe debatet me bashkëshorten Luçiana Naraçi e bija e Gertrude Buheckes - vjehrrës së Velos. Më poshtë deklaratat e dy grave, nënë e bijë për raportin e tyre me Maksin dhe akuzat se ai nuk kujdesej për të shoqen e të birin.

DOKUMENTI 8 SEKRET

Ekzemplar i vetëm Tiranë, më 04.07.1975 Shënim operativ Sot më datë 04.07.1975 pata një bisedë në prezencë të p. operativ Gëzim Bejko, me qytetaren Gertrudë Buheckes, që banon në rrugën "Bajram Curri" 36/4, p. 10. Kjo ishte vjehrra e Maks Velos që ndiqet nga ana jonë në P. Paraprak për agjitacion e propagandë. Gertruda u ankua për dhëndrin e saj Maksin, si dhe për të bijën, se ata e trajtojnë shumë keq, madje edhe e rrahin. Gertruda është me kombësi austriake. Ajo, duke qarë, fliste me një urrejtje të madhe për Maksin dhe familjen e tij. Për Maksin, ajo thoshte se është njeri hipokrit, egoist. Ndërsa për familjen e tij, familje aristokrate. "Më ka ndodhur - tha ajo - në ndonjë rast të shkoj të shtëpia e tyre dhe kam degjuar fjalët e së ëmës së Maksit, e cila më thoshte se Maksin im është rritur me çokollata, se ai ka lindur në Paris etj. Vajza ime, vazhdon më poshtë Gertruda, qysh se është martuar me Maks Velon ka humbur fare. Ajo madje ka hum-

Vjehrra Gertrudë Buhecke: Ime bijë më thotë që po qe se do t'i ndodhë gjë Maksit, dije se kam për të të zhdukur ty".



Maks Velo i sapodalë nga burgu

bur dhe botëkuptimin e saj të mëparshëm. Megjithatë Maksin e trajton shumë keq, ajo përsëri e do atë. Qysh se është martuar me time bijë, Maksin nuk ka sjellë asnjë lek në shtëpi, madje as tani që ka lindur djalë. Ai është një tip psikopati dhe shumë i ulët në karakter. Tani ka dy a tre muaj më ka sjellë në shtëpi vajzën me gjithë djalin dhe nuk interesohet fare për ta. Do që ta ndajë

time bijë dhe guxon që ta padisë në gjyq. Me një fjalë, Maksin është një tip borgjezi që unë nuk gjej fjalë ta shpjegoj karakterin e tij. Ai tani më quan mua spiune, se gjoja kam dorëzuar dy libra të tij në Degën e Brendshme, që kanë përmbajtje jo të mirë. Unë me të vërtetë kam shpënë dy libra në Lidhjen e Shkrimtarëve që më janë dukur jo të mirë, por jo në Degën e Brendshme. Nuk e di kush mund t'i ketë thënë Maksit për këto. Madje, edhe ime bijë më thotë që po qe se do t'i ndodhë gjë Maksit, dije se kam për të të zhdukur ty. Ime bijë madje më ka goditur mua. Ajo është bërë si e luajtur mendsh. Në këtë gjendje atë e solli Maks Velo. Vajza ime ka rënë në një pesimizëm të madh sa që mua më zë merakur se ajo për shkak të Maksit mos kalon në vetëvrasje. Dua ta bind që të shtrohet në spital, por ajo nuk pranon me mua. I them që ta ndajë Maksin, por ajo përsëri nuk pranon".

Punëtori operativ / Ropi Postolli/

Shënim: Maks Velo ka tentuar vazhdimisht nëpërmjet së bijës së Gertrudës që kjo të kërkojë në Austri nga e motra e saj për t'i dërguar plaçka atij. Tani si do ta lërë të bijën e Gertrudës? Tani ose ata të dy duan të shfrytëzojnë Gertrudën dhe formalisht bëjnë sikur nuk shkojnë mirë, ose me të vërtetë marrëdhënet e tyre janë ashtu siç thotë Gertruda. Punëtori operativ / Ropi Postolli.

E SHOQJA Dokumenti 45 DEKLARATË

Unë e nënshkruara Luçiana Naraçi deklaroj si më poshtë: Unë kam ardhur për të thënë në drejtim të Maks Velos, me të cilin kam qenë e celebruar dhe jemi ndarë në mars 1976 për motive: për qëndrime të huaja karshi gruas. Gjatë kësaj bashkëjetese kam konstatuar te Maksi se ishte i dhënë pas artit dekadent. Ai në shtëpi kishte piktura që për mendimin tim nuk i përgjigjeshin realizmit socialist.

Pasi është dënuar Fadil Paçrami, Maksi është shprehur në një bisedë me familjen e vet, ku isha dhe unë prezente se: "Fadili qëndroi si burrat nuk e dha veten". Në kohën që Maksi u dërgua për riedukim në fshat, thoshte se "mua më kanë dënuar kot, këta nuk dinë të vlerësojnë njerëzit, mua më hoqën se jam i zoti". Lidhur me jetesën, Maksi shprehej se nuk na dalin lekët, megjithatë merrte 800 lekë në muaj dhe nuk kontribuonte asgjë për shtëpinë dhe për djalin. Ai thoshte shpeshherë se këtu nuk vlerësohet puna dhe arti, "të ishin këto piktura që kam bërë unë jashtë shtetit do të vlerësoheshin shumë. Ato do të kushtonin miliona". Maksi ka pasur marrëdhënie me një franceze me të cilën mbante korrespondencë. Ajo i ka ardhur disa herë në shtëpi. Ka dalë në fotografi me të. Kjo ka marrë si dhuratë nga Maksi disa piktura, ndërsa Maksi ka marrë si dhuratë nga ajo libra të ndryshëm, midis tyre dhe një libër të Pikasos. Ka dalë jashtë Tiranës me të. Maksi shpeshherë më fliste për francezen dhe për jetën atje, që në Francë do të çmoheshin shumë veprat e Maks Velos, pasi aty çmohet çdo gjë ndryshe. Lidhur me veprat e Pikasos, Maksi thoshte që është piktor i madh botëror, thoshte "shiko sa të bukura janë pikturat e tij". Në fakt, ato piktura nuk kishin asnjë vlerë edukative. Në shtëpinë e Maksit, në një rast ka ardhur edhe një grek, të cilin familja e Maksit i ka treguar studion e tij. Maksi ka lënë në shtëpinë e mamasë sime dy libra të karikataturistit francez Zhan Eifel, në gjuhën ruse. Këta libra tregojnë për krijimin e njeriut nga Zoti dhe krijimin e botës. Autori është reaksionar dhe këto i dorëzova në Drejtorinë e Brendshme. Maksi shprehej se autori është karikaturist nga më të mirët e botës dhe veprat e tij janë me vlerë. Në librat e të atij kam gjetur një fotografi të Maksit që ka dalë me vëllain në moshën e fëmijërisë të veshur ushtarakisht me uniformë fashiste duke përshëndetur me dorë. Këtë fotografi e kemi dorëzuar në Drejtorinë e Brendshme.

**Deklaruese Luçiana Naraçi
Tiranë, më 16.III.1978**



VELO ELE

urimit të Shtetit)
ndjekjes, hetimit, gjykimit dhe t
da me Alda Bardhylin

punë pa vlerë, pa kuptim dhe ekstravagante. Maksi është shoqëruar edhe me Mihal Hanxharin. Maks Velo dhe ndonjë simpatizant i tij, e maskonin krijimtarinë e tij gjoja se ajo bazohet në motive popullore. Kur ka qenë në institut si pedagog Maks Velo gjithashtu ka pasur shfaqje të theksuara të huaja në punën e tij me studentët. Për këtë gjë mund t'u flasim më mirë ata që e njohin nga afër për këtë periudhë".

Punëtori operativ / Ropi Postolli/
Hektori më tha edhe faktin se e ka parë Maksin me gruan e tij dhe fëmijën nga shtëpitë e gjer-manëve te kodrat.

Akuzat për moral, "ai kryen marrëdhënie me turistet gjermane e franceze"

ka pasur lidhje me turistë të huaja gjermane e franceze. Për këto takime të tij me turistet e huaja i është tërhequr disa herë vëmendje, por ai përsëri ka vazhduar të takohet me to. Për të vërtetuar marrëdhëniet e tij me turistet e huaja, Maksi është marrë në P. P. në vitin 1973, por nuk doli gjë me rëndësi. Ai takohet me turistet e huaja si njeri i degjeneruar për të kryer marrëdhënie seksuale.

DOKUMENTI 23 Raport dt. 20.07.1977

Maksi shfaq mendimin duke thënë: "Këta tani do ta kenë shumë të vështirë në të gjitha drejtimet po u prishën me kin-

ezët. Pse bëhet kështu siç po bëjnë këta? Po prishen me gjithë botën.... Dikur kam pasur një dashnore franceze, ishte fantastike. Femrat tona nuk janë kur- rë në gjendje të jepen ashtu siç jepej ajo, sepse femra jonë ka gjithmonë halle dhe nuk mund ta ketë mendjen vetëm të dashurisë. Femra jonë nuk mund ta ketë kurrë atë feminilitet që ka një femër e huaj, sepse si mund ta ketë kur ti vete dhe e çon atë në aksion dhe në punë fizike"...

Burimi di se Maksi ka pasur dashnore, e cila e ka zyrën afër shtëpisë së Maksit. Gjithmonë ka pasur dhe një arsimtare të shkollës së Ndroqit, të shoqin e së

cilës e njoftoi për marrëdhënien e tij, pasi ajo grua u nda nga Maksi. "SEMANI"

DOKUMENTI 38 Raport dt. 06.03.1978

Maksi ka qejf ta fusë në dorë këtë vajzë, pasi dhe kjo njihet si vajzë e shthurur. Po kështu, Maksin kërkon të lidhë marrëdhënie me një punonjëse në kombinatin e tekstileve "Stalin", e cila ka dashur të fejohej me Islam... i dënuar. Po kështu ka një vajzë nga Elbasani e quajtur... babai i saj ka qenë kryetar i DPB të Elbasanit, tani është në pension. Me të ka marrëdhënie të vazhdueshme intime, por nuk do ta marrë...

Agresorët përplasen edhe me policinë. Dy në pranga dhe një në kërkim

Maskat tentojnë të grabisin banesën, përleshjen dhe plagosin ish-tregtarin

62-vjeçari, autorëve: Me vrisni po të doni, para nuk kam

Senad Nikshiqi

SHKODËR

Një grabitje e ngjashme me skenarët e filmave ka ndodhur në orët e para të mëngjesit të djeshëm në Shkodër. Maska, armë, dhunë, përleshje me policinë dhe largim nga vendi i ngjarjes i njërit prej autorëve është gjithçka çfarë ka ndodhur në një banesë trekatëshe ngjitur me shkollën 9-vjeçare "Ismail Qemali" të këtij qyteti. Mësohet se tre persona të maskuar dhe të armatosur kanë hyrë pa u vënë re në shtëpinë e Agron Veselit, në lagjen "Kongresi i Përmetit". Agresorët kanë kërcënuar 62-vjeçarin se do ta vrisnin nëse nuk u jepte paratë, por i zoti i shtëpisë u është përgjigjur: "Më qëlloni, se para nuk kam". Pas konfrontimit fizik, Veseli ka mbetur i plagosur. Përplasja e tij me grabitësit është dëgjuar nga fqinjët, të cilët njoftuan policinë. Pas sinjalizimit për ngjarjen, blutë e qytetit verior bënë të mundur identifikimin dhe kapjen e dy prej autorëve të krimit. Bëhet fjalë për shtetasit Pëllumb Kolbuçaj 45 vjeç dhe Abdullah Hardhiçaj, 53 vjeç, të dy banues në Shkodër, ndërsa është shpallur në kërkim 20-vjeçari me inicialët F.Sh., banues në këtë qytet.

NGJARJA

Burime për 'GSH' bënë me dije se grabitësit pasi janë futur brenda oborrit, kanë



62-vjeçari i plagosur Agron Veseli

pritur derisa 62-vjeçari ka hapur derën e shtëpisë dhe me shpejtësi kanë hyrë brenda. Menjëherë i kanë drejtuar armën në kokë kryefamiljarit dhe i kanë kërkuar para. Njëkohësisht autorët e kanë goditur pa pushim Agron Veselin në

kokë dhe trup, duke e gjakosur atë. I gjendur në vesh-tirësi, por edhe me një litër në fyt, Veseli ka bërë të mundur duke kërkuar ndihmë nga komshinjtë. Salla operative ka marrë një njoftim për një zhurmë dhe menjëherë është nisur drejt

PRONARI I BANESËS

Agron Veseli, i cili u dhunua barbarisht nga grabitësit nuk është martuar asnjëherë dhe nuk ka fëmijë. Ai më përpara merrej me tregti, ndërsa kohët e fundit ka lëshuar me qira 2-3 dyqane poshtë ndërtesës 3-katëshe të tij. Ngjarja e rëndë ka tronditur komshinjtë dhe persona të tjerë të njohur të Agron Veselit. Policia po punon për zbardhjen e plotë të kësaj ngjarjeje.

vendit të ngjarjes. Edhe pse ndërtesa kishte pajisjen e sinjalit të një prej policive private, ardhja e tyre ishte shumë e vonë. Kur janë futur brenda oborrit, blutë kanë dëgjuar të zotin e shtëpisë duke thënë: "Po më grabisin". Ndërkaq, agresorët kanë tentuar që të largohen. Njëri prej tyre nuk ia ka dalë, sepse është arrestuar në flagrancë nga policia. Idyshuari Pëllumb Kolbuçaj fillimisht është ndaluar nga shefi i rendit, Saimir Rustemi. Të ndodhur të dy mbi një gardh, 45-vjeçari ka arritur që t'i rrëshqasë shefit të rendit. Sapo ka zbritur në tokë në oborrin e shkollës 9-vjeçare "Ismail Qemali", i ka dalë

para efektivit Shkëlzen Gjonaj. Këtë të fundit e ka goditur në shpatull, duke tentuar që të largohet. Gjonaj e ka bllokuar, ndërsa menjëherë ka ndërhyrë shefi i rendit, Rustemi edhe efektive të tjerë duke arritur ta arrestojnë Kolbuçajn, edhe pse ai ka rezistuar. Dy autorët e tjerë kanë arritur të largohen fillimisht duke kapërcyer muret e disa banesave aty pranë. Abdulla Hardhiçaj u arrestua pak orë pas ngjarjes, ndërsa është shpallur në kërkim autori i tretë, 20-vjeçari F.Sh.. Fillimisht u mendua se dy autorët e tjerë mund të ishin fshehur brenda shkollës, por pas kontrollit rezultoi se nuk ndodheshin aty.

DËSHMIA E TË PLAGOSURIT

I dhunuari Agron Veseli u dërgua me ambulancë në spital. Sipas mjekëve, ai kishte plagë në kokë, fytyrë dhe trup. Ndërkaq, ai ka deklaruar para bluve se kur ka hapur derën e shtëpisë, autorët të maskuar me armë në dorë dhe të veshur me të zeza dhe doreza në duar i kanë kërkuar paratë. "Ata më thanë do të të vrasim. Unë iu përgjigja: Më vrisni po të doni, para nuk kam". Persona e maskuar e të armatosur më goditën ku mundën. Isha vetëm në shtëpi", është shprehur 62-vjeçari. Mësohet se Agron Veseli nuk është martuar asnjëherë dhe nuk ka fëmijë. Ai më përpara merrej me tregti, ndërsa kohët e fundit ka lëshuar me qira 2-3 dyqane poshtë ndërtesës 3-katëshe të tij. Ngjarja e rëndë ka tronditur komshinjtë dhe persona të tjerë të njohur të Agron Veselit. Policia po punon për zbardhjen e plotë të kësaj ngjarjeje.

BalkanWeb.com

AGJENCIA E LAJMEVE MË E KLIKUAR NË HAPËSIRËN SHQIPTARE.
LAJMET MË TË FUNDIT MË VIDEO DHE FOTO NGA VENDNGJARJA,
ANALIZA DHE TEMATIKA TË NDRYSHME, GJITHÇKA ME NJË KLIKIM.

MERRNI NE KOHE REALE
LAJMET E FUNDIT NE
APARATIN TUAJ



INSTALONI APLIKACIONIN E BALKANWEB NE MOBILE DHE TABLET

KERKONI NE APPLE STORE DHE GOOGLE PLAY OSE DUKE SKANUAR QR CODE APPLE DHE ANDROID

BalkanWeb.com
BW

FALAS





BLUE TOOTH

Thashetheme
MADE IN ALBANIA

Nr. 620

SUPLEMENT I PERJAVSHEM GAZETA SHQIPTARE

Art Designer: Nevila Samarxhi

E shtunë 28 Korrik 2018

HISTORIA E FEJESSES ALBI NAKO & ALBA HOXHA



Çifti zyrtarizon marrëdhënien pranë familjes, por ende larg unazës

JA DEPUTETET QE ZGJEDHIN JUGUN E SHQIPERISE





Politikanët me pushime në zonat e tyre elektorale

AGRON SHEHAJ,
BABA PER
HERE
TE TRETE



VIP-a NE PLAZH

Pushimet luksoze të Elvana Gjatës me të fejuarin. Ilda Bejleri nuk zhvishet më



Xherdan Shaqiri, pushime me të dashurën në Nju Jork

Lidhja sekrete e futbollistit të famshëm

Xherdan Shaqiri ishte ndër futbollistët më të spikatur në këtë Botëror. Veçmas paraqitjes në fushë, futbollisti shqiptar që luan për Zvicrën do të kujtohet gjatë edhe për simbolin e shqiponjës që bëri pas golit kundra Serbisë. Megjithatë, edhe për futbollistin pushimet kanë nisur, e duket se po i shijon në maksimum. Xherdan Shaqiri prej disa ditësh ndodhet në Nju Jork, së bashku me miqtë e tij. Ka qenë fotografi i mirënjohur, Fadil Berisha, ai që ka publikuar foto të Shaqirit. Megjithatë, ajo e cila nuk duket në foto është edhe partnerja e tij. Bëhet me dije se futbollisti ka udhëtuar drejt Nju Jorkut, së bashku me të dashurën. Çifti është në një lidhje prej disa muajsh, megjithatë duket se Xherdani ka zgjedhur që këtë histori ta mbajë sa më larg publikut, duke e përjetuar vetëm me miqtë e ngushtë. Mbetet për t'u parë edhe për sa kohë kjo histori rozë do t'i shpëtojë syrit të publikut.



Era Istrefi kopjon Alban Ramosajn?

Ja thumbat e artistëve në rrjetet sociale

Era Istrefi ka publikuar këngën e saj të re "Oh God", në bashkëpunim me artistin xhamajkan Konshens. Por, duket se ky klip është i ngjashëm me atë që Alban Ramosaj pritet të nxjerrë pas pak ditësh në treg. Era shfaqet provokuese buzë detit, teksa në sfond bien rrufetë, një skenë kjo e ngjashme edhe me atë të klipit të Albanit. E që të mos nisin thashethemet, ka qenë vetë këngëtarja që ka thumbuar Erën. "Era Istrefi sa kilowatt janë vetëtimat andej nga bregu yt?", ka komentuar Albani, i cili është ndeshur me përgjigjen plot humor të këngëtares. "Hahah thashë mos të kisha kopjuar, por qenka koincidence".



Paqe mes Soni Malajt dhe Olti Currit

Dy personazhet shfaqen së bashku pas gjyqit

Pas disa vitesh Olti Curri dhe Soni Malaj përfunduan gjyqeve me akuza dhe kundër akuza, por sot duket se gjithçka është lënë pas. Këngëtarja dhe opinionisti janë takuar në një festë mode në Durrës dhe në intervistë për emisionin "Pushime on Top" kanë pranuar se ky është takimi i parë publik që pas historisë së gjyqit ku artistja e paditi Oltin për fyerje. Soni Malaj paditi në gjykatë 2 vite më parë për fyerje Olti Curri, pas një statusi të këtij të fundit në rrjetet sociale. Ai publikoi një foto të Sonit ku shkruante "Nderim Tunës", e cila është tjetër mikeshë e Oltit.

Balerina dhe koreografi, detajet e historisë së dashurisë

Historia e fejesës së Albi Nakos dhe Alba Hoxhës

Prej gati një viti balerina Alba Hoxha përfillet se është dashuria e re e koreografit të njohur, Albi Nakos. Të shumta kanë qenë rastet kur të dy janë munduar t'i shmangen përgjigjes, nëse janë apo jo në të vërtetë në një romancë. Por duket se zërat edhe pas një viti nuk janë mundur të shuhet. Ditët e fundit ka qenë vetë balerina, ajo që ka "provokuar" fansat duke postuar një foto me unazë. "Unazën e gjeta, por më mungon...", ka shkruar Alba në foton ku shihet me unazë në dorë. Të shumtë ishin ata që aluduan se çifti është në hapat e fundit të përgatitjeve për ceremoninë e tyre të fejesës. Mirëpo të dy, edhe Albi, edhe Alba e kanë mohuar një fakt të tillë. Koreografi, i pyetur nga Revista "Class" u shpreh se ky lajm është i rremë. Ndërsa Alba ka publikuar një foto në "InstaStory" ku shkruan, "Beqare dhe e lumtur", duke treguar në këtë mënyrë se nuk bëhet fjalë për fejesë. Megjithatë, "Bluetooth" ka mundur të mësojë se çifti nuk do të organizojë asnjë fejesë apo ceremoni për kurorëzuar dashurinë e tyre. Ashtu si edhe më herët kemi thënë Albi dhe Alba prej kohësh janë bashkë, por duket se planet për një festë janë ende larg. Historia e tyre e dashurisë tashmë është një fakt për

Çifti zyrtarizon marrëdhënien pranë familjes, por ende larg unazës

Nga Eglja XHEMALI



miqtë apo edhe familjarët e të dyve, ndaj festa "duhet të presë edhe pak". Albi Nako vjen nga divorci me balerinën e mirënjohur Klaudia Pepa. Të gjithë e kujtojmë dasmën e tyre, në televizionin "Klan" në sytë e të gjithë publikut. Ndaj, zor se edhe këtë herë Albi, në një moshë më të pjekur do të zgjedhë të bëjë publike celebrimin e dashurisë së tij. "Bluetooth" ka mësuar se kjo lidhje shihet me simpati edhe nga familjet e çiftit të ri, që tanimë nuk i kursejnë as darkat familjare, duke celebruar kështu dashurinë e tyre, por akoma pa një unazë. Vite më parë, Alba ishte një nga studentet e Albit, e cila u rrit artistikisht në sytë e koreografit të saj, deri kur i rrembeu zemrën. Pas rolit si vëlinë në emisionin "Stop", tashmë Alba Hoxha është edhe imazhi i "Klanit" për motin. Ndërkaq, edhe Albi vijon punën e tij si koreograf pranë këtij televizioni. Duket se për të, kjo është historia e dytë e dashurisë, lindur në korridorët e televizionit. Mbetet për t'u parë edhe sa kohë do t'i duhet këtij çifti për "të ndarë mendjen", e ta pranojnë publikisht se tashmë janë një ndër çiftet e "shoëbiz"-it shqiptar. E ndërkaq, ne do të vijojmë të mbledhim copëza detaje nga kjo histori dashurie kaq e rezervuar.

Foto që "tradhtoi" çiftin

Prej disa muajsh në mediat 'online' qarkulloi lajmi se Albi Nako dhe balerina Alba Hoxha kanë nisur një lidhje të re dashurie. Ata janë komentuar si çifti i ri i "showbiz"-it shqiptar, nisur nga disa foto që kanë postuar në "Instagram", ku u shfaqën të dy në Paris. Në një prononcim të tijin, Albi ka pranuar se ka qenë së bashku me Albën në Paris, por për një arsye të madhe. Koreografi i njohur dhe balerina e TV "Klan" kanë udhëtuar drejt Belgjikës, Parisit dhe Amsterdimit për një projekt që do të vënë në jetë së shpejti dhe për të cilin po përgatiten prej

kohësh. "Ne jemi këtu për punë, vetëm kaq. Situata është e tillë: ne postojmë një foto dhe kaq mjafton të bëhet lajm. Po udhëtojmë me Albën, sepse po nënshkruajmë kontrata me disa balerinë të huaj, kryesisht 6 balerinë italiane, të cilët do i bashkohen trupës së baletit. Së shpejti, rikthehemi në Tiranë për të vënë në jetë projektin. Kaq është e gjitha...", është shprehur Albi pak muaj më parë rreth fotove që qarkullojnë. Megjithatë, edhe pas këtij lajmi, miqtë dhe persona të afërt të çiftit zbuluan se kjo detyrë tashmë është bashkë.



VIP-a në plazh


Pushimet luksoze të Elvana Gjatës me të fejuarin. Ilda Bejleri nuk zhvishet më

Tashmë që edhe muaji i korrikut është drejt përfundimit, plazhi dhe pushimet janë të vetmet gjëra që na vijnë ndërmend. E sidomos, VIP-ave tanë, që i kanë nisur pushimet e tyre prej disa kohësh. Edhe këtë javë të nxehtë personazhet publikë kanë preferuar të na provokojnë me foto të nxehta nga bregdeti. Në top-formë, plot stil dhe provokuese, jo është pamja e VIP-ave që këtë javë na sjellin më shumë freski.

Fotot provokuese të femrave seksi buzë detit

Elvana Gjata

Duket se kjo është vera e Elvana Gjatës. Këngëtarja pas suksesit të dy këngëve të saj të fundit, "Ku vajti", "Mike", ka nisur pushimet e saj të luksit me të fejuarin. Vetëm para pak ditësh e pamë teksa udhëtonte në Francë me partnerin në brigjet franceze me helikopter. E nga riviera franceze, Elvana ka udhëtuar drejt Amalfit, në Itali, me jaht. E pas një viti të ngarkuar, këngëtarja duket se i meriton pushimet e luksit, së bashku me partnerin e saj biznesmen.



Ilda Bejleri

E dhe për moderatoren ky sezon ka qenë tejet intensiv. Pasi përfundoi Kampionati Botëror, Ilda Bejleri duket se ka gjithë kohën për të shijuar pushimet. Ka qenë një nga resortet e Turqisë, zgjedhja e saj. Por ajo që na ra në sy këtë herë është se Ilda ka preferuar që në fotot e postuara të mos shfaqej me bikini. Shpeshherë jemi mësuar ta shikojmë provokuese me format super, por gjatë gjithë pushimeve, këtë herë ajo ka zgjedhur të postojë foto me fustan dhe jo me kostum plazhi. Ç'të ketë ndodhur vallë?

Aurela Hoxha

Aurela mund të mungojë në Shqipëri prej disa kohësh, por në "Instagram" kurrë. "Showgirl"-i prej kohësh ka zgjedhur Spanjën për të promovuar edhe më shumë biznesin e saj të bikinive. E kush më mirë se ajo do të ishte modelja e linjës së saj. Aurela ka postuar ditët e fundit shumë foto me bikini, ku bashkë me linjën e re, ajo reklamon edhe format bombastike që gëzon.




Zaimina Vasjari

Këngëtarja seksi prej pak muajsh është bërë nënë e një vajze. Por duket se lindja s'ka lënë as shenjë më të vogël tek Zai. Kjo verë e ka gjetur atë së bashku me partnerin, Klodi dhe vogëlushen e tyre me pushime. Fotot që Zaimina ka postuar në rrjetet sociale kanë nderur edhe njëherë temperaturat. Buzë pishinës, apo në jaht, ç'rëndësi ka, Zaimina Vasjari mbetet një sex-bomb e vërtet.

VIP-a në plazh

Françeska Jaçe

Vajza nga Vlora duket se e ka harruar famën që i dha "Big Brother", pasi si modele ajo vijon të mbetet ndër më të lakuarat. Ndaj, ajo më mirë se kushdo e di se çfarë impresionin lënë fotot e saj me bikini. Një verë plot aventura dhe pushime po kalon Françeska, e cila shfaqet gjithnjë provokuese, por vetëm. "Zoti është grua", ka shkruar modelja në foton e postuar me bikini buzë detit. E me këtë foto, vështirë se ka kush e kundërshton.



Rike Roçi

Me forma bombastike dhe plot sharm, Rike Roçi nuk ngurron të nxjerrë në pah asetet që gëzon. Por e çuditshmja ka ndodhur këtë javë, kur bukuroshja ka preferuar të mbulohet. Buzë detit me bikini, Rikja ka vendosur mos të zbulohet e gjitha, por të mbulojë trupin e saj me një shalqi para. Më shumë sesa për të fshehur linjat, kjo është një ide e re fotech, që duket e huazuar nga VIP-at ndërkombëtarë.

POLITI



KANE

Nga Egla Xhemali

Me përfundimin e sesionit parlamentar edhe politika ka nisur pushimet. Pas një sezoni të ngjeshur me akuza politike dhe zhvillime, tashmë është koha që politikanët të zhveshin kostumet zyrtare për të qenë pranë detit së bashku me familjen. Në prononcimin e tyre për "Bluetooth", ajo që ra në sy është se shumica e deputetëve do t'i kalojnë pushimet pranë zonave të tyre elektorale. Të gjithë ligjvënësit e pyetur kanë rrëfyer se do t'i kalojnë pushimet në Shqipëri.

Alket Hyseni

Si deputet i Vlorës, Alket Hyseni nuk kishte sesi të mos promovonte jugun. Në përgjigjen e tij, ai është shprehur se do të shijojë të gjithë rivierën e jugut. Më tej, ai bën thirrje që të gjithë të kalojnë pushimet në Shqipëri. "Kryesisht me zonën time që përkon me bregdetin më të bukur në Mesdhe, në rivierën shqiptare nga Vlora, në Sarandë dhe Ksamil. Pushime të mbara dhe ju dhe ju presim në jug. Mos shpenzoni kot jashtë Shqipërisë", u shpreh deputeti.



Nada Meçorapaj

Edhe deputetja e Partisë Demokratike ka zgjedhur zonën e saj për të shijuar ditët plot relaks. Duket se veçmas ditëve të pushimit, Nada do të jetë edhe më pranë votuesve të saj. "Pushimet verore do i kalojë në Vlorë dhe në Dhërmi me familjen", u shpreh ajo në prononcimin dhënë për "Bluetooth".



Deputetët që zgjedhin Politikanët me pushime

Izmira Ulqinaku

Unë do i kaloj pushimet në Shqipëri, pjesën më të madhe të kohës në zonat turistike që mbulon qarku i Shkodrës", u shpreh deputetja e re e qarkut të Shkodrës. Duket se Izmira nuk ngjason aspak me moshataret e saj që preferojnë clubet e jugut, apo resortet jashtë Shqipërie.



Ermonela Felaj

Edhe për Ermonelën, këto do të jenë ditë të mbushura me diell dhe det. Besnike e jugut të vendit, ajo është shprehur se nuk do ta braktisë as këtë vit. Së bashku, me familjen Ermonela Felajn mund ta gjeni përgjatë bregdetit të jugut. "Unë do i kaloj pushimet në Shqipëri, në jug kryesisht në Sarandë".



ME PU SHIME



Ervin Salianji

Pushimet për deputetin e Korçës do të nisin pikërisht nga zona e tij elektorale. Ervini duket se këtë verë do të shkelë gjithë Shqipërinë, duke shijuar si detin ashtu edhe malin. "Do jem në Shqipëri, në turn në disa pika turistike nga Thethi, në Dardhë dhe Voskopojë. Në Dhërmi, Pogradec dhe në Golem në plazhin e mirëmbajtur me shumë kujdes nga bashkia Kavajë", u shpreh Salianji.



Senida Mesi

Gushti do ta gjejë përsëri zëvendëskryeminstren në Shkodër. Por këtë herë Senida Mesi do të shkojë si pushuese në Velipojë. "Kryesisht do jetë në Velipojë shumicën e pushimeve, mund të kalojë ndonjë fundjavë në Shëngjin dhe Sarandë", u shpreh ajo. Duket se edhe për Senidën pushimet do të kenë pak punë brenda.



jugun e Shqipërisë në zonat e tyre elektorale



Eduart Shalsi

Edhe pse me një fëmijë të porsalindur, edhe deputeti i PS, Eduart Shalsi do të shijojë disa ditë pushime. Por edhe Shalsi, si shumica e kolegëve të tij ka zgjedhur zonën e tij elektorale Pogradecin. "Ku më mirë se në zonën time elektorale, Pogradec". Ndoshta veç bukurive natyrore, ky qytet është i përshtatshëm edhe për një familje me një fëmijë të vogël.



Vilma Bello

Pushimet e deputetes së PS kanë vetëm një kryefjalë, familja. E ashtu sikurse ajo vetë u shpreh, një familje e madhe. Si një vlonjate, ajo zgjedh Radhimën për pushimet e këtij viti. "Në Radhimë, si 13 vjet rresht, me familjen time të madhe, burrin, vajzat dhe prindërit e tim shoqi, me të cilët jetoj", u shpreh ajo.



Evis Kushi

Për deputeten e Partisë Socialiste kanë nisur tashmë pushimet në Pogradec. Por, duket se ky është vetëm fillimi, pasi pas liqenit, Evisi do t'i drejtohet perlës së jugut të vendit. "Aktualisht jam duke pushuar një javë në Pogradec bashkë me familjen. Na pëlqen këtu qyteti, liqeni, klima, Driloni, Tushemishti etj. Ndërsa, në fillim të gushtit kemi planifikuar një javë buzë Jonit në jug të Shqipërisë".



Agron Shehaj, baba për herë të tretë



Agron Shehaj është një nga politikanët më të diskutuar, kjo si pasojë edhe e përfshirjes që ka në biznes. Edhe pse jeta e tij është e ndarë midis këtyre dy fushave, Shehaj gjithmonë ka pohuar se nuk bën jetë pasaniku. Burime për "Bluetooth" kanë zbuluar se deputeti dhe bashkëshortja e tij janë në pritje të ëmbël. E shoqja e Shehaj është shtatzënë e pritjet që të lindë fëmijën e tretë në muajin gusht. Mesa duket, kjo verë nuk do t'i gjejë duke bërë pushime, pasi deputeti pret të bëhet baba. Shehaj e ndan kohën mes qyteti të Vlorës dhe Italisë, ku ka familjen. Sapo gjen kohën, ai udhëton për tek ata. "Në familje flitet shqip. Fëmijët kanë lindur në Itali, gjuha e tyre kryesore është italishtja, por duhet të mësojnë e dhe gjuhën e prindërve. Origjina nuk duhet harruar kurrë", shprehet biznesmeni i suksesshëm për dy fëmijët. Deputeti ka preferuar që në daljet në media apo në intervista të ndryshme të mos prononcohet për aspektin e pasurisë dhe në një farë mënyre të mbajë larg jetën private, megjithatë ne urojmë që fëmija të vijë shëndetplotë e të ketë jetë të gjatë!



Afërdita Dreshaj i rikthehet muzikës



Përveçse si modele, Afërdita Dreshaj ka spikatur edhe si këngëtare. Me siguri të gjithë i mbani mend këngët e saj "Qyteti Hesht", "Shumë trafik", "Another 1" apo "Mos rri larg". Megjithatë, Afërdita ka rreth dy vite që qëndron larg muzikës, për shkak të angazhimeve në jetën e saj private. Gjithsesi, ajo nuk mund të

mos i rikthehej sërish pasionit të saj dhe tani që çdo gjë me jetën e saj personale është në rregull, është plotësisht gati të sjellë këngë të reja për fansat e saj. Madje, në një intervistë të pak kohëve më parë, Afërdita ka treguar se do të vazhdojë të merret me shumë me muzikën dhe këngët. Këto fjalë nuk ishin të kota, sepse duket se ajo ka nisur xhirimet e klipit për këngën e re. Afërdita ka publikuar në

rrjetin social "Instagram", në "Instastory" një video duke pozuar përpara kamerës për videoklipin që pritet të publikohet. "Koha për një këngë të re?", – ka shkruar ajo. E shtrirë në një shtrat, Afërdita dukej si gjithmonë në formë perfekte dhe më sensuale se kurrë dhe me siguri, edhe klipi i saj do të jetë i kuar në çdo detaj.

Opinioni Ditës

Letër Pëllumb Kullës në Shtetet e Bashkuara të Amerikës

Cili do të jetë fati i Teatrit Kombëtar?

Nga Leka Bungo

(vijon nga faqja 1)

... dritat dhe do të kemi mundësi të komunikojmë rregullisht si më parë.

Këtej oqeanit, në katundin tonë, punët shkojnë si jo më mirë. Jo edhe aq sa do të dëshironite udhëheqja, por gjithsesi shumë më mirë se në vitin 1938.

Nëse të kujtohet, para se ju të mbeteshit pa energji, më kishe drejtuar dhjetëra pyetje të cilave nuk mund t'u jap përgjigje vetëm me një e-mail.

Një nga pyetjet e veçanta, për të cilën jo vetëm ti, por të gjithë njerëzit e skenës janë të shqetësuar është pa dyshim se "Cili do të jetë fati i ndërtesës së Teatrit Kombëtar?"

Shqetësimin tënd e kanë edhe më shumë këtu: përlëshen filozofët, analistët, regjisorët, aktorët, kritikët, përfaqësuesit e shoqërive civile dhe ushtarake, spektatorët... Të gjithë janë përfshirë në një debat të madh.

Ajo që është për t'u habitur, o miku im, është hera e parë që partitë politike nuk janë bërë pjesë e kësaj përlëshjeje. Përkundrazi! Kanë qëndruar aq shumë jashtë loje, sa që populli me të drejtë ka nisur të shqetësohet si mund t'i kemi partitë kaq moskokëçarëse!

Të vetmit njerëz që mëngjes, drekë, darkë merrin me këtë punë në ekranet e televizioneve, apo në shtypin e përditshëm janë Petrit Vasili, Ylli Manjani, Enkelejd Alibeaj dhe ndonjë tjetër, që nuk kanë asnjë lidhje me partitë politike.

Në të vërtetë, sipas gjykimit tim, po të përjashtojmë Flamur Nokën, që zakonisht merakoset për repertorin, palët në konflikt nuk kanë si objekt ecurinë dhe përpunimin e teatrit, por ndërtesën e Teatrit Kombëtar.

Njëra palë është për ta shembur, ndërsa pala tjetër është për ta mbajtur.

Një grup tjetër, më i vogël në numër, është dakord që të ndërtohet një Teatër i ri Kombëtar modern për Shqipërinë e së ardhmes, por... ky i vjetri, kurrsesi të mos shembet!

Me fjalët të tjera, këta i japin më shumë rëndësi muzeut të teatrit se vetë teatrit, a thua sikur është e pamundur që brenda ndërtesës së teatrit të ri, të përfshihet edhe muzeu!

Debatit është ndezur dhe përhapur aq shumë sa nganjëherë të krijohet përshtypja se populli i ynë nuk i ka problem as varfërinë, as taksat, as strehimin, as shkollimin, por "shembjen apo rikonstruksionin e asaj ndërtesës prapa ministrive!"

E kam vrarë mendjen shpesh këto ditë si është e mundur që Robert Ndenikës, Reshat Arbanas, Pëllumb Kullës, Gëzim Kames, Albert Mingës, Artan Imamit, Sotirajq Bratkos, Luftar Pajës dhe shumë të tjerëve që kanë lidhur jetën me veprim-



tarinë teatrore dhe janë larguar nga skena vetëm ditën kur kanë dalë në pension, t'u u dhimbset teatri më pak se Fatos Lubonjë, Andi Bushatit, Përparim Kabos, Artur Zhejit, Artan Fugës, që prapun e teatrit e kanë kapërcyer vetëm si spektatorë me bileta.

I dashur Pëllumb!
Këto që shkrova më lart nuk janë flakët që mbajnë ndezur konfliktin për Teatrin Kombëtar. Jo! Një sy i hollë, "shumë i hollë", pas Teatrit të ri Kombëtar sheh të fshehur korrupsionin e qeverisë. Madje, ata që ngulin këmbë për këtë flasin edhe me shifra.

Kam dëgjuar me veshët e mi, se nga kjo marrëveshje e fshehtë autoritetet qeverisëse dhe konkretisht Edi Rama me Erion Veliajn do të përfitojnë mbi dyqind milionë euro!

Nuk janë pak, apo jo? Ata do të lëshojnë mbi letër vetëm nga një firmë dhe do të marrin nga njëqind milionë secili, kurse ti, o lumëmadh, ke shkruar e vënë dhjetëra shfaqje në skenë, tani pret sezonin kur ulet çmimi i biletave ajrore për të ardhur në Shqipëri! (Nga njëqind milion them unë, se Edi mund të marrë edhe më shumë... Le që ç'më duhet mua, puna e tyre se si i ndajnë!).

Pra, miku im, siç e sheh, rrënjët janë shumë më të thella se sa duket pemët.

Miku i im, ti gjithmonë ke thënë se unë jam më i mençur se ti. Dhe ke thënë një të vërtetë të qartë si drita e diellit. Dhe që të mos pendoheh për përcaktimin tënd objektiv, po të them se unë kam arritur të depërtoj në thellësi të kësaj historie.

Nuk është fjala as për shembje, as për ndërtim, as për nostalgji dhe as për korrupsion. Gjetiu fshihet leperi. Pas kësaj historie qëndron një marrëveshje e heshtur.

Në qoftë se të gjithë kundërshtarët e projektit të Edi Ramës dhe Erion Veliajt janë të bindur se nëpërmjet kësaj afere do të përfitojnë milionat e eurove, përse nuk i lenë ata që të realizojnë pikësynimin e tyre korrupsiv?!

Kjo do të bënte që kryeqyteti i Shqipërisë do të fitonte ndërtesën e re dhe madhështorë të Teatrit Kombëtar, kurse nga ana tjetër, duke ndjekur logjikën e atyre që i kundërshtojnë, Edi Ramën dhe Erion Veliajn, do t'i kishim të përfunduar në qelqet e burgut!

I mbajmë të dy në një qeli apo i ndajnë, ajo është puna e drejtorisë së burgeve.

Mirëpo ata kanë angazhuar të gjitha forcat për të kundërtën. Ata duan ta pengojnë me çdo kusht shembjen e ndërtesës së teatrit, vetëm e vetëm që kryeministri dhe kryetari i bashkisë të mos fusin dot në xhepa ato dy-

qind milionë euro! Por, ama, kështu ata do t'i shpëtojnë burgut dhe pastaj do t'i kemi mbi krye edhe dhjetëra vite të tjera! Marrëveshje e fshehtë i thëncin, por më e zbuluar se kjo, zor se mund të ketë.

E marr me mend, shumë gjëra kur i sheh nga përtej oqeanit duken paradoksale, por tek shqiptarët mund të hasësh gjëra edhe më të çuditshme.

Ne i njohim mirë. Para ca vjetësh, ne që të dy kemi qenë vetë shqiptarë.

Duke përfunduar për sot, të uroj gjithë të mirat!
Leka

p.s.
Më doli nga mendja dhe nuk ta shkrova më lart. Dikush solli një dëshmi që mund ta kish sjellë me kohë: përpara se të vdiste regjisori i madh Mihal Luarasi, i paske lënë porosi që kjo, ndërtesa që ka sjellë sherrin, të mos shembet. Nga ana tjetër një burrë fort i moshuar, që paska qenë në Kajro më 1930, tregoi se fjalët e fundit të Çajupit paskan qenë: "Nuk do të më tretë dheu po s'ma panë shqiptarët '14 vjeç Dhëndrin' tim në mes të Tiranës, në një teatër madhështor, pa kompensato italianësh"! Pisk e kemi, o Pëllumb! Po që se, paturpësisht, do të fusim që të votojnë edhe të vdekurit...
Pres të më shkruash.

HOROSKOPI

DASHI
Ditë e mirë për të investuar në pasuri të patundshme dhe për të kryer transaksione financiare. Do të zgjeroni bazën tuaj të miqve dhe të njohurit, nëse merrni pjesë në funksione dhe ngjarje sociale. Do të përfitonit nga disa ndryshime që do të ndodhin në punë.

DEMI
Kontrolloni temperaturën tuaj, duke shmangur tensionet. Përfitim i parave nuk është në ditën më të mirë. Çdo vendim i nxituar mund t'ju kushtojë shumë. Dashuria pritet të ecë mirë.

BINJAKET
Sot mos e shtyni veten në vëshitërsi. Gjendja shëndetësore nuk është në formën më të mirë dhe paletëtu ju nevojitet pak pushim. Ushtroni kujdes, mençuri dhe durim, teksa merrni me njerëzit në punë.

GAFORJA
Bëni një shtetje të gjatë për hir të shëndetit tuaj. Ju do të keni një dëshirë për të fituar shpejt. Mbaje veten të angazhuar në aktivitetet shtëpiake. Në të njëjtën kohë kaloni disa kohë në aktivitetet kreative për të fituar energji pozitive.

LUANI
Mund të keni vëshitërsi që të kontrolloni emocionet. Sjelja juaj e pazakontë do të ngatërrojë njerëzit rreth jush, por kjo do të zhgënjë vetëm një person, ju. Të qenit hakmarrës ndaj një personi e keni pasur në zemër nuk do të sjellë ndonjë rezultat.

VIRGJERESHA
Shanset për t'u shëruar nga një problem fizik janë të mëdha. Bëni kujdes me buxhetin për të shmangur problemet financiare në të ardhmen. Ju do të ndiheni të lodhur sot kur të zbuloni se dikush që i keni besuar gjithmonë nuk është shumë i sigurtë me ju.

PESHORJA
Shmangni alkoolin e tepërt dhe bëni kujdes me ngjarjen e makinës. Formula e sôtme për sukses është të besoni kështyllën e njerëzve, të cilët janë inovativë dhe kanë përvojë të mirë. Aktivitetet shoqërore së bashku me familjen do të ishin shumë të pëlajshme.

AKREPI
Mbajeni në aktivitet shëndetin tuaj mendor, gjë që është parakusht për jetën shpirtërore. Mendja është porta e jetës, sepse gjithçka nëse është e mirë apo e keqe vjen nëpërmjet mendjes. Ndihmon në zgjidhjen e problemeve të jetës dhe ju jep dritën e nevojshme.

SHIGJETARI
Shmangni qënjeshtrat, sepse mund të shkatërronë lidhjen tuaj të dashurisë. Bëni shumë kujdes me një individ që mund të përipiqtë t'ju mashtrtojë, ose t'ju japë informacione që mund t'ju shkaktojnë ndonjë dëm.

BRICJAPI
Duhet ta kaloni kohën e lirë në ndjekje të një hobi, ose duke bërë gjëra që ju pëlqejnë më së shumti. Marrëdhëniet me të dashurin mund të tensionohen për shkak të ndërhyrjes së një personi të tretë. Ditë e mirë për artet.

UJORI
Një surprizë e vogël mund t'ju ndryshojë të gjithë gjendjen shpirtërore. Qëndrimi juaj dominues do të bëjë që të merrni kritikë nga kolegët. Sot do të ketë shumë çështje, të cilat kanë nevojë për vëmendje të menjëhershme në punë.

PESHQIT
Mbajeni veten të përfshirë në aktivitetet që do t'ju ndihmojnë të kaloni stresin. Situata financiare do të përmirësohet pasi të paguani disa borxhe. Miqtë do ta ndriqojnë ditën tuaj kur të planifikoni diçka emocionuese për brmbajtjen.

Opinion i Ditës

Si u rrëzua Gjykata Kushtetuese

Nga Gjergj Erebara

(vijon nga faqja 1)

... dorëhequr ose kanë mbaruar mandatet, katër janë rrëzuar në veting dhe vetëm dy kanë mbijetuar. Por mbyllja e përkohshme e kësaj gjykate mund të jetë vetëm një pjesë e problemit, pasi mënyra e emërimit të anëtarëve të rinj sipas Kushtetutës së re dhe fakti që kaq shumë vakanca do të duhet të plotësohen njëherësh krijon shqetësime për funksionimin normal të saj për së paku disa vite. Nga ana tjetër, Gjykata e Lartë, e cila sipas Kushtetutës duhet të furnizojë tre anëtarë në Gjykatë Kushtetuese, mund mbesë me më pak se tre anëtarë në fund të procesit të vetingut.

Sistemi i drejtësisë sipas Kushtetutës së re është krijuar me një numër mekanizmash ndërvarësie, por periudha e tranzicionit nga sistemi i vjetër deri në sistemin e ri po rezultojnë në vështirësi për shkak të vakancave të krijuara në të gjithë strukturën nga procesi i vetingut dhe dorëheqjet.

Gjykata Kushtetuese është një nga shumë gjykatat që janë jashtë funksionit, ose pjesërisht jashtë funksionit në Shqipëri. Gjykata të ndryshme rrethesh kanë prej vitesh funksionalitet të pjesshëm, pasi me raste kanë vetëm dy gjyqtarë, ndërsa u nevojiten tre për të krijuar trupë gjyqesore në çështje të rëndësishme. Por ndryshe nga gjykatat e tjera, Gjykata Kushtetuese u shpërbë në masën dërrmuese nga procesi i vetingut dhe nga dorëheqjet dhe tërheqjet nga posti i gjyqtarëve të lidhura me procesin e vetingut.

Gjykata Kushtetuese kishte nëntë anëtarë në vitin 2015, kohë kur ishte në funksion të plotë. Por në prill të vitit 2016, gjyqtari Vladimir Kristo i mbaroi mandatin. Sipas Kushtetutës, Kristo duhej të vijonte të mbante detyrën në pritje të zëvendësimit, por në korrik të vitit 2017, Kristo njoftoi se nuk dëshironte më të vijonte punën dhe u tërhoq. Tërheqja nga vijimi i punës pas përfundimit të mandatit e shpëtoi Kriston nga procesi i vetingut, por ndërkohë la efektivisht bosh një pozicion, që për mbi një vit nuk ishte plotësuar.

Në të njëjtën kohë, anëtari Sokol Berberi vendosi të tërhiqej nga pozicioni pasi i kishte mbaruar mandatin që në vitin 2016. Largimi i Berberi e uli në shtatë numrin e anëtarëve efektiv të Gjykatës Kushtetuese.

Besnik Imeraj, i cili ishte emëruar anëtar i Gjykatës Kushtetuese në vitin 2013 dha dorëheqjen në janar të këtij viti "për arsye personale dhe shëndetësore". Imeraj i shpëtoi procesit të vetingut, por Komisioni i Pavarur i Kualifikimit e referoi atë në prokurori. Rezultati i referimit nuk dihet.

Dorëheqja e Imeraj e uli num-



rin e gjyqtarëve kushtetues në gjashtë.

Fatos Lulo ishte anëtari i parë i Gjykatës Kushtetuese dhe gjyqtari i parë që u nënshtrua procesit të vetingut. Më 23 mars, Komisioni i Pavarur i Kualifikimit e shpalli atë të papërshtatshëm, me argumentin se dispononte pasuri të shumta me burime të pajustificuara. Lulo zgjodhi të mos paraqitej vetë në komision, por dërgoi një avokat. Ai e apeloj vendimin e komisionit, ndërsa Kolegji i Posaçëm i Apelitit e rrëzoi kërkesën e tij më 17 qershor.

Më 23 prill, Altina Xhoxhaj u ngel në veting për mospërfutje deklarimesh, mosjustifikim pasurie dhe mungesë të ardhurash. Xhoxhaj është në pritje të apelit në Kolegji.

Më 10 maj vetingu rrëzoi Fatmir Hoxhën, duke e lënë Gjykatën Kushtetuese me tre anëtarë, ndërsa në korrik, Gani Dizdari, i fundit që u nënshtrua vetingut, u shpall gjithashtu i papërshtatshëm.

Vetë kryetari i Gjykatës Kushtetuese, Bashkim Dedja u konfirmua nga Komisioni i Pavarur i Kualifikimit, por në seancën dëgjimore u ngritën pikëpyetje të mëdha mbi britimet e krijimit të pasurisë së tij. Vendimi i zbardhur i komisionit zbuloi se komisionerët ishin të ndarë në opinionin e tyre nëse Dedja do të duhej të provonte me dokumente

se persona të lidhur me të kishin të ardhura të ligjshme për t'i dhënë atij hua për blerjen e një apartamenti me vlerë 180 mijë euro.

Historia e Dedes duket se nuk mbaron këtu. Javën e kaluar, Institucioni i Monitorimit ka rekomanduar apelinin e vendimit për konfirmim në detyrë të tij. Komisionerët publikë kanë afat deri në fund të kësaj jave për të vendosur apelinin apo jo.

Vetëm një nga nëntë anëtarët fillestarë të Gjykatës Kushtetuese, gjyqtarja Vitore Tusha, e cila u konfirmua në 5 prill është tashmë e konfirmuar në detyrë dhe vendimi nuk është apeluar në Kolegjin e Posaçëm të Apelitit.

ZËVENDËSIM I VËSHITIRË
Kushtetuta sanksionon që vakancat në Gjykatë Kushtetuese të zëvendësohen me emërime të kryera nga tri institucione të tjera, me kushtin që renditja fillestare e listës së aplikantëve të bëhet nga një institucion i katërt i quajtur Këshilli i Emërimeve në Drejtësi. Këshilli, i cili u krijua më 19 mars 2013, përbëhet nga një përzgjedhje me anëtarë nga gjykata të ndryshme dhe anëtarët përcaktohen me short të hedhur nga Presidenti i Republikës. Problemi është se nga lista e anëtarëve të parë të KED (link) disa kanë rënë, ndërsa disa të

tjerë presin vetingun. Mbetet e paqartë se si KED do të arrijë të rendisë kandidatët për vendet vakante të Gjykatës Kushtetuese, funksion që duhet ta kryejë para se presidenti dhe parlamenti të kryejnë emërimet përkatëse.

Por, problemi më i madh lidhet me tre anëtarë të Gjykatës Kushtetuese, që duhet të zgjidhen nga Gjykata e Lartë. Gjykata e Lartë kishte 17 anëtarë në fillim të vetingut, por ka mbetur aktualisht me gjashtë anëtarë, nga të cilët tre janë konfirmuar në shkallën e parë të vetingut, ndërsa tre të tjerë janë në pritje. Nga tre të konfirmuarit, njëri, Xhezair Zaganjori nuk mund të zgjidhet në Gjykatë Kushtetuese, pasi ka qenë më parë në këtë institucion, ndërsa tjetri, Edmond Islamaj, ndërpret apelin e vetingut. Edhe në rast se tre të mbeturit kalojnë vetingun, sërish Gjykatës së Lartë do t'i duhet të plotësojë tri vakanca në kushtetuese, ndërkohë që njëri prej tyre duhet të jetë anëtar dhe kryetar i Këshillit të Emërimeve në Drejtësi dhe si i tillë nuk dihet nëse do të mund të kandidojë veten për anëtar të Gjykatës së Kushtetuese.

Mosfunksionimi i përkohshëm i Gjykatës Kushtetuese është konsideruar sakaq si një problem i rëndë nga opozita politike, por edhe nga ekspertët të ndryshëm. Pavarësisht se shumica e anëtarëve të kësaj gjykate u rrë-

zuan në veting ose u tërhoqën para vetingut, kjo gjykatë i është përgjigjur një numri të lartë kërkesash për antikushtetutshmëri ligjesh ose vendimesh qeverie, ndërsa së paku një ligj aktual i parlamentit, ai për teatrin kombëtar ka ngritur pikëpyetje mbi kushtetutshmërinë.

Por, mosfunksionimi i përkohshëm është njëra anë e problemit. Ana tjetër është rreziku i vonesave të gjata të zëvendësimit të të gjithë anëtarëve që mungojnë si dhe faktin që Kushtetuta e vitit 2016 nuk është krijuar me supozimin që shumica dërrmuese e gjyqtarëve kushtetues do të iknin apo rrëzoheshin.


Kushtetuta aktuale sanksionon që radhët e gjykatës Kushtetuese të rifreskohen një herë në tre vjet me nga 3 anëtarë, me synimin e krijimit të vijimësisë dhe larmishmërisë. Sipas Kushtetutës, tre anëtarë do të duhet të emërohen nga Presidenti i Republikës, tre anëtarë zgjidhen nga Kuvendi dhe tre anëtarë zgjidhen nga Gjykata e Lartë. Që të gjithë duhet të vijnë nga një përzgjedhje paraprake e kryer nga Këshilli i Emërimeve në Drejtësi. Problemi është që një pjesë e funksionarëve të KED nuk i janë nënshtruar akoma procesit të vetingut.

Por, përveç faktit që funksionimi i KED nuk është i sigurt, problemi tjetër lidhet me Gjykatën e Lartë, e cila duhet të furnizojë tre anëtarë të kushtetueses, por ka pësuar humbje të mëdha nga dorëheqjet, tërheqjet pas mbarimit të mandatit dhe vetingut. Gjykata e Lartë ka aktualisht gjashtë anëtarë efektive, nga të cilët tre janë konfirmuar në Komisionin e Pavarur të Kualifikimit, ndërsa tre të tjerë presin vetingun. Nga tre të konfirmuarit, njëri ka qenë sakaq në Gjykatë Kushtetuese, ndërsa një tjetër e ka vendimin e konfirmimit në Apel.

Njëri nga gjyqtarët, Ardian Dvorani është sulmuar nga Partia Demokratike si person i kryeministrit Edi Rama. Kryetari i PD, Lulzim Basha protestoi pak ditë më parë duke argumentuar se Dvorani, të cilit i ka mbaruar mandati si anëtar i Gjykatës së Lartë "pritet të dërgohet në Kushtetuese nga Edi Rama". Në fakt, Dvorani mund të jetë nga të vetmit të mbetur në Gjykatë të Lartë për të plotësuar vakancat në Gjykatë Kushtetuese.

Sipas Kushtetutës, anëtarët e rinj të gjykatës do të duhet të marrin mandatin e mbetur të gjyqtarit që ka lënë pozicionin vakant. Kjo do të thotë se pesë nga nëntë anëtarët e ardhshëm do të kenë mandate të pjesshme. Procesi i zgjedhjes së tyre pret në çdo rast krijimin e Këshillit të Emërimeve në Drejtësi, ndërsa vetë KED pret të shohë nëse mes radhëve të saj do të ketë apo jo të mbijetuar të mjaftueshëm nga vetingu për të plotësuar radhët./Reporter.al

Fjalëkryqi (1)



- 37. Janë baballarët.
- 38. Fillojnë titrat.
- 39. Ai dhe ajo.
- 40. Mbledh baskët separatistë.
- 41. Fillojnë saldimit.
- 42. Gjysma e krahut.
- 45. Në krye të armatës.
- 46. Gjysmë krisme.
- 47. Jepet për hartim.

- VERTIKAL**
- 1. Paul që qe poet i famshëm.
 - 2. Dennis i McLaren.
 - 3. Këndohet në opera.
 - 4. Gjysmë siklet.
 - 5. Kufijtë e matjes.
 - 6. I zhvillon kongresi.
 - 7. Inicialet e Moravia-s.
 - 8. Janë krerë bandash.
 - 9. Të fundit në tender.

HORIZONTAL

- 1. Humanisti i Rotterdemit
- 6. Mund të jenë cigaresh.
- 12. Capirossi i MotoGP.
- 13. Eshhtë bixhoz
- 14. I vetmi në orar.
- 15. Para Diego në Kaliforni.
- 16. Fillojnë sefte.
- 17. Eshhtë makina për guidë.
- 21. Inicialet e Benigni-t.
- 23. Janë riparime.
- 25. Janë të brishtë.
- 27. Fillojnë largimin.
- 28. Ishin kambistë të dikurshëm.
- 29. Një motokaf gare.
- 31. Kështu thirrej Marco Pantani.
- 32. Janë penjtë për moline.
- 33. Emër vajze.
- 35. Janë edhe ato të cirkut.
- 36. Nuk ka tradhtari.

- 10. Fund shkurti.
- 11. Mund të jenë grossistë
- 13. Ka shirit magnetik një e tillë.
- 15. Ishin engjejt të korit të lartë
- 17. Janë glynahet.
- 18. Bega komik.
- 19. Janë shemra.
- 20. Inicialet e Morricone-s.
- 22. Janë edhe ato fetare.
- 23. Një gjuajtës francez.
- 24. Gjika e Dora D'Istria-s.
- 26. Qytet grek.
- 29. Bëjnë katrorë me një kat.
- 30. Ishin ndjekësit e Antistentit.
- 32. Shkruhet i treti.
- 34. Një sulm... kardiak.
- 36. Ki Moon i OKB
- 40. Inicialet e Rohmer.
- 43. Robert Mitchum.
- 44. Dy asa.


Fjalëkryqi (2)

HORIZONTAL


- 1. Bëhet një me psonisje.
- 5. Një mund të jetë qeveritar
- 11. Maiden që këndojnë.
- 13. Një ushtarake është solemn.
- 15. Inicialet e Mann shkrimtar nobelist.
- 16. Teket pa kufij.
- 18. Mbetet në fund.
- 19. Një treshe në skenë.
- 21. Një mongol i Timurlengut
- 23. Një peshk i rëndë.
- 25. Tiriac ish-tenist
- 26. Kufizojnë një takim.
- 27. U hodhën në Tartar nga Zeusi
- 30. Fillojnë nazet
- 31. Kalimi në krye.
- 32. Ishite gruaja që i dha ujë nga pusi Jezusit.
- 34. Janë portet.
- 35. Dashi kur mungon ai
- 37. Javier, shefi i diplomacisë së BE
- 38. Kufizohet në kufij
- 39. Ente Civile Europeane.

VERTIKAL


- 1. Brad aktor.
- 2. Komandohet nga gjenerali.
- 3. Në hyrje të zonës
- 4. Janë në skaje
- 6. Janë librat e parë
- 7. Mund të jetë arme.
- 8. Inicialet e Turgeniev.
- 9. Ndërmarrje Industriale Tiranë.
- 10. Mund të lakohet.
- 12. Janë arkanidët si veshjua e zezë.
- 14. Mund të jetë e lirë në port.
- 17. Një mjet lundrimi.
- 20. Shkroi Rinoceronti.
- 22. Ekstremitë në ritëm.
- 24. Kalohen në gjumë.
- 28. Filmi i parë shqiptar.
- 29. Fillojnë takimet
- 31. Kufizojnë kënde.
- 32. Një depozitë drithi.
- 33. Janë vendet e para.
- 34. Një parabolë e tenistit.
- 36. Eshhtë logari që qërohet.
- 37. Shteti me Khartum.
- 38. Janë kapot e bandave.
- 40. Një thirrje e dëshpëruar nga direku.
- 41. Lidhin brigje.
- 42. Një lidhëz
- 46. King Cole i muzikës.
- 48. Fillojnë ndeshjen.
- 49. Sapo fillojnë.
- 50. Mbetet në fund.



Gjeni ndryshimin



Dy figurat kanë ndryshime nga njëra-tjetra



Përgjigja, ja cilat janë ndryshimet e figurave

SUDOKU

		2	9			8		3
9	5	4					1	
			2	1				7
	9			6	3		7	8
5			4		8			1
4	3		7	9			2	
7				3	9			
	1					7	6	5
8		6			5	2		

Plotësoni vendet bosh në mënyrë që çdo kolonë të ketë numrat nga 1-9

Përgjigje e sudokut të numrit të kaluar

5	1	9	4	7	3	2	8	6
2	4	7	6	5	8	3	9	1
3	6	8	2	1	9	4	7	5
7	9	2	8	3	5	6	1	4
4	3	1	7	9	6	5	2	8
6	8	5	1	2	4	7	3	9
1	5	6	3	8	7	9	4	2
8	7	4	9	6	2	1	5	3
9	2	3	5	4	1	8	6	7

PËRGJIGJET E FJALËKRYQJVE TË NUMRIT TË KALUAR

FJALËKRYQI (1)

HORIZONTAL

1. PETRIKA ASPAK
6. TRUP TALENTI A
12. BEI SANDOKAN
13. TAMAROCI I H
14. PI E EN A O DRE
15. AC T O N E K K A O S
17. RA T R A P E T E A L M A P
18. E L S A V A L R O N E
19. R I T M A L L A R M E T

VERTIKAL

1. MA B U S E H A N E T
2. O R E K S B D E M O N I
3. R A S T K A B I T E R E T P
4. T A M A R O C I I H
5. A I K I M B O I N I R K
6. R A S A P A G A N I N I M
7. T A V E R R K A D O T M
8. M A R S I A N E T J A
9. M A T F O R M A T
10. H A R K A N I R I E M E T
11. A S I T I R A D A M E S
12. S H A M A T A L O T U S

Argëtim filozofik

- Ndershmëria është kapitulli i parë në librin e mençurisë.

- Kush duket i mençur midis budallenjve, duket budalla midis të mençurve.

- Eshhtë më lehtë t'i bësh keq një njeriu të mirë, se sa t'i bësh mirë një njeriu të keq.

- Statistikat janë si minifundet. Ato tregojnë shumë, por fshihin thelbin.

- Askush nuk është aq i pasur që të mos ketë nevojë për një buzëqeshje. Dhe askush nuk është aq i varfër që të mos mund ta jap!

Thënie të mençura

- Njeriu inteligjent do të gjej rrugëdalje nga një situatë e vështirë. I mençuri nuk do të gjenden në këtë situatë.
- Mos ki nevojë për asgjë, dhe do ti kesh gjithçka.
- Mos ki nevojë për asnjë, dhe do ti kesh të gjithë.

KRIPTOSKEME
Përgjigja e numrit të djeshëm

4 2 9 4 1 10 5 10

2 F 7 8 6 15 3 6 10 3

10 2 8 5 3 9 3 7 9

5 K 1 2 3 11 3 4 7 5 8 4

1 A 2 8 11 1 12 8 11 3 13 8

5 3 6 3 12 8 13 8 1 6

5 11 3 16 3 6 6 6 1

1 7 4 3 13 7 3 6

2 3 8 7 5 1 11 3 4

7 6 4 1 4 3 13 7 4 3 6

11 3 2 16 8 11 9 15 4

7 4 8 6 8 16 8 3 10

M A S H U R K A I R A K
E S T E R A D H U N A
I T E A T E R M I N
E R A P O L A R T A
K E L P O L E M I K A T
L P O L I G A M I
E T A P I K A T R E L
K O M O D E N T O K E
T R I S E T M N U N
I T T U T U I T I D
K A D E T K O S H L E
E T I K S E K S E R E T

- Nuk ka rëndësi se kush je dhe sa i bukur je.
- përderisa ekziston dikush që të dashuron.
- Heshitja e bën bisedën reale midis miqve. Ajo që ka rëndësi nuk është të flasësh, por të mos kesh nevojë për të folur.

